



## **Vlerësim i gjendjes së minoriteteve në Kosovë** **(në periudhën kohore prej Tetorit 2000 deri në Shkurt 2001)**

### **Përmbledhje ekzekutive**

Në këtë raport të përbashkët të shtatin me rradhë, qëllimi ynë është që t'ju japim një pasqyrë mbi situatën e sigurisë me të cilën janë duke u përballuar komunitetet minoritare në Kosovë. Në të njëjtën kohë ne do të fokusohemi në një numër të zgjedhur të çështjeve që brengosin siç janë: kthimi i tyre, qasja ndaj shërbimeve shëndetësore, çështjet pronësore, pjesëmarrja në strukturat politike dhe mundësia për punësim. Format i saj ndryshon deri diku prej asaj të raportit të kaluar për sa i përket fokusimit të saj në një sërë çështjesh thelbësore siç janë të kundërvëna në shqyrtimin gjithëpërfshirës në fjalë. Përderisa kjo paraqet rrjedhojë të një vendimi të marrë me kujdes me qëllim të përpilimit të një vlerësimi që mbërthen më shumë çështje, dhe gjithashtu është një reflektim i një realiteti të vërtetë dhe të ngurtë që mbizotëron këtu. Me kalimin e kohës, mungesa e një progresi të qëndrueshëm për popullatën minoritare nënkupton se jemi duke rrezikuar që vetëm do të përsërisim disa çështje, shqetësime dhe rekomandime që janë shtjelluar gjerësisht në vlerësimet e kaluara.

**Mungesa e vazhdueshme e sigurisë së mjaftueshme (adekuate) mbetet njëra prej çështjeve më thelbësore për minoritetet.** Periudha gjatë së cilës jemi duke raportuar shënohet me një keqësim të situatës së përgjithshme të sigurisë. Si pikënisje e gjithë kësaj ishte vrasja e katër të kthyerve Ashkalinjë, përderisa fundi ishte i përshkuar me një seri të sulmeve vdekjepruese kundër serbëve të Kosovës nëpër disa prej rrugëve kryesore të transportit të cilat ato i përdorin për ti mbajtur lidhjet e tyre me Serbinë. Këto sulme arritën kulminacionin e tyre me masakrën e 16 Shkurtit e cila për shënjestër kishte autobusin e "Nish Ekspres-it", në të cilën dhjetë serbë, duke përfshirë këtu edhe një çift bashkëshortor së bashku me foshnjën e tyre, vdiqën. Periudha ndërmjet këtyre dy ngjarjeve karakterizohet me një rritje të numrit të sulmeve kundër pjesëtarëve të popullatës minoritare dhe pronës së tyre. Asnjë grup etnik nuk ka mbetur pa u dëmtuar në këtë aspekt duke përfshirë këtu edhe shqiptarët e Kosovës të cilët në një mënyrë de facto paraqesin një grup minoritar nëpër disa prej zonave me shumicë serbe në krahinë. Intenziteti thuajse i pazvogëluar i dhunës jo vetëm që ka lëkundur vetëbesimin i cili mbizotëron tek minoritarët të cilët ndihen disi si të ekspozuar ndaj kësaj dhune, mirëpo kjo gjithashtu ka krijuar njëfarë ndjenje të frustrimit dhe të pasigurisë edhe tek popullata shumicë shqiptare. Ngjarjet e këtyre muajve të fundit kanë minuar mjaft seriozisht përpjekjet e përqëndruara drejt stabilizimit dhe përmirësimit të situatës së përgjithshme të sigurisë.

Shkalla e përsosshmërisë (sofistikimit) dhe planifikimit të sulmeve të kohëve të fundit, siç është sulmi me snajper mbi konvojin nën përcjellje të serbëve të Kosovës të cilët ishin duke udhëtuar për në Shtërpce dhe sulmi mbi shërbimin "Nish Ekspres" të autobusëve si sfida e ka karakterizimin e dhunës së vazhdueshme që është duke ndodhur kundër pjesëtarëve të minoriteteve si një dhunë e përshkuar nga sulme të izoluara të kryera nga individët të cilët për motiv e kanë hakmarrjen. Mund të del se ekziston një fushatë e orkestruar, apo një sërë fushatash të organizuara, nga deri më tani elementë të panjohur të cilët për qëllim të vetëm

kanë terrorizimin e popullatës pakicë, pengimin e demokracisë dhe bashkëjetesën paqësore. Numri i keqbërësve të arrestuar ndaj të cilëve me sukses është iniciuar ndjekja penale në lidhje me këto sulme mbetet mjaft i vogël.

Ekziston një pëlqim (pranim) i përgjithshëm i dhënë nga ana e komuniteteve vendore për sa i përket të drejtës për kthim, mirëpo në këtë drejtim mund të themi se nuk janë ndërmarrë veprime të mjaftueshme nga ana e komuniteteve vendore me qëllim të demonstrimit të zotimeve të tyre ndaj parimeve në fjalë. Ekziston një numër shumë i vogël i njerëzve të cilët kanë marrur guximin që të marrin një qëndrim të ashpër kundër prapavijës (kulisës) së jotolerancës dhe dhunës që është duke ndodhur momentalisht dhe gjithashtu ata kanë qenë aq të guximshëm sa që kanë ngritur zërin kundër situatës së tanishme në vend duke i zëvendësuar fjalët me veprime konkrete. Mirëpo kjo prapëseprapë nuk do të thotë se nuk ekziston asnjë prej tyre. Mu për këtë arsye ne jemi munduar që të zgjedhim një sërë çështjesh mjaft të ndërlikuara që kanë të bëjnë me kthimin me qëllim që të japim një reflektim sa më të drejtë dhe sa më të saktë për sa i përket përparimit të deritanishëm i cili është bërë në këtë drejtim duke mos humbur nga sytë pengesat tejet të mëdha të cilat duhet tejkaluar në këtë drejtim. Në vazhdim situata e paqëndrueshme dhe e brishtë në jug të Serbisë dhe konfliktet e fundit të cilat janë duke u zhvilluar në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë janë një faktor mjaft rëndësues në këtë aspekt. Ndikimi i mundshëm negativ që kjo mund të ketë në pjesën e mbetur të minoriteteve në vend, e cila për rrjedhojë mund të ketë zhvendosje të mëtutjeshme të tyre, kurrësi nuk bën të injorohet.

Qasjen ndaj **kujdesit shëndetësor** e kemi zgjedhur si një shembull ilustrativ për sfidat me të cilat ballafaqohemi për momentin në përpjekjet tona për të siguruar një mundësi të drejtë dhe të qëndrueshme për qasje ndaj shërbimeve elementare, dhe atë në një ambient tejet të polarizuar siç është Kosova. Çka kemi parë gjer më tani, fatkeqësisht, është përparimi tejet i vogël i cili është arritur që nga raportet e kaluara. Përpos zotimeve dhe përpjekjeve që meritojnë çdo lëvdatë të bëra nga ana e shumë individëve të devotshëm të Departamentit të Drejtësisë, strukturave komunale dhe ata që vijnë nga një numër i shumë i OJQ-ve, sigurimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor ende shënohet me një ndarje të saj për grupe të caktuara etnike. Kanosja e shprehur ndaj situatës së sigurisë mund të duket si një përzierje e diskriminimit dhe jotolerancës, duke e bërë të nevojshme shfrytëzimin e disa prej masave speciale, siç janë klinikat mobile dhe transporti nën përcjellje i pajisjeve mjekësore.

Sulmet mbi pronën dhe okupimi i paligjshëm i pronës ende shfrytëzohen si mjete me qëllim të ndjekjes me forcë të komuniteteve minoritare ose pengimit të kthimit të tyre. **Zdjidhja e drejtë e kontesteve pronëso-ro-juridike** si dhe **shpërndarja e paanshme dhe e drejtë e ndihmës për rindërtim** janë disa prej aspekteve që kanë të bëjnë me çështjen e pronës në përgjithësi dhe janë të lidhura ngushtë me kthimin e mundshëm dhe të qëndrueshëm të personave minoritar. Çka ne mundohemi të paraqesim në këtë raport është se, përpos njohjes e cila është në rritje e sipër për sa i përket rëndësisë së kësaj lidhjeje, ekzistojnë edhe pengesa të tjera të cilat duhet luftuar dhe tejkaluar si dhe në fund të gjindet një zgjidhje e qëndrueshme për to. Financimi i pamjaftueshëm vazhdon të pengojë efikasitetin e punës së Drejtoratit për Çështje Banesore dhe Pronësore.

**Pjesëmarrja në strukturat politike** ka fituar në peshë (seriozitet) sidomos në dritën e përfundimit të zgjedhjeve komunale të mbajtura në tërë krahinën. Pjesëmarrja e qytetarëve në këto zgjedhje ishte tejet e lartë, ku edhe shumë komunitete minoritare gjithashtu kishin marrur pjesë në mënyrë aktive me përjashtim të serbëve të Kosovës dhe një pjese të komunitetit turk. Përderisa UNMIK-u është duke ecur përpara drejt zvogëlimit në fazën të pjesëmarrjes së ndërkombëtarëve nëpër disa sektore të administratës, strukturat komunale janë duke u bërë gjithnjë e më të rëndësishme. Në këtë raport, ne kemi për qëllim që t'iu japim një pasqyre të përgjithshme në lidhje me faktin se si pushteti i kooptimit është duke u shfrytëzuar nga ana e PSSP-së. Kjo paraqet njërin prej mjeteve i cili mundëson vlerësimin e shkallës së inkorporimit të përfaqësuesve të grupeve minoritare nëpër strukturat e sapoformuara komunale. Vetëm prezenca e tyre nuk mjafton për të garantuar pjesëmarrjen e tyre dhe mu për këtë arsye ne jemi duke u munduar që ti lëmë mënjanë numrat dhe të fitojmë një lloj sensi për atë se sa aktive, sa e rëndësishme dhe se çfarë roli influencues mund të luajnë ata në nivel komunal. Ajo çka është paraqitur në këtë raport për nga nevoja është

limituar në vlerësimin paraprak. Me zhvillimin e strukturave komunale gjithashtu do të lind nevoja për një monitorim të vayhdueshëm të tyre.

Në kapitullin **qasja ndaj punësimit** ne do të fokusohemi në punësimin në kuadër të strukturave komunale, si një pikënisje e rëndësishme drejt trajtimit të drejtë të pakicave kombëtare. Çka kemi parë këtu është se praktikant ndryshojnë prej një komune në tjetrën dhe andaj është mjaft herët të nxirren përfundime të qëndrueshme në këtë aspekt. Punësimi i minoriteteve kërkon një dozë të caktuar të zotimit dhe fleksibilitetit që duhet të vie në shprehje nëpër të gjitha komunat. Njësoj lind edhe nevoja për zotim dhe bashkëpunim që duhet të mbizotërojë ndërmjet vetë pjesëtarëve të minoriteteve. Si edhe shumë e shumë çështje të tjera, siguria paraqet një aspekt i cili nuk mundet të parashihet, përderisa punësimi i pakicave në këtë fazë mund të kërkojë marrjen e masave speciale të cilat implikojnë burime materiale për masat në fjalë. Është shumë me rëndësi që minoriteteve tu jipet e drejta për qasje ndaj mjeteve juridike me qëllim që të kenë mundësi ti ngrisin çështjet për sa i përket diskriminimit të tyre si nëpërmjet të ndërmjetësimit ashtu edhe nëpërmjet të procedurës ligjore.

Me ecjen e Kosovës drejt autonomisë substanciale siç është e paraparë me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244, trajtimi i popullatës minoritare dhe përmirësimi i kushteve me të cilat ato momentalisht ballafaqohen mbetet një çështje kyçe në këtë aspekt. Është diçka e cila është e njohur për të gjithë e sidomos në rastin e Kosovës është e njohur klisheja e formuluar saktë se një shoqëri demokratike vlerësohet më së miri nga fakti se si ajo e trajton popullatën minoritare e jo se si e trajton atë shumicë. Gjer më tani, e ashtuquajtura sjellje (shfaqje) e Kosovës është vuar në pyetje përderisa në muajt e ardhshëm vëmendja e bashkësisë ndërkombëtare do të përqëndrohet në këtë çështje e cila qëndron si një pikë krahasuese për administratën ndërkombëtare për sa i përket suksesit të saj të arritur në Kosovë.

-----

## Siguria

1. Në vlerësimet e mëparshme, ne në mënyrë konsekuente (qëndrueshme) kemi potencuar faktin se **siguria është një brengë e shtuar për komunitetet minoritare**. Kjo nuk ndodh vetëm për shkak të ndikimit të menjëhershëm dhe të drejtëpërdrejtë që e shkakton dhuna në individët pjesëtarë të minoriteteve që kanë qenë në shënjestër të këtyre sulmeve (dhune), mirëpo gjithashtu edhe për shkak të implikimeve të gjera që kjo mund të ketë për lirinë e lëvizjes së këtyre personave si dhe për ushtrimin e një sërë të drejtash elementare në këtë drejtim. Situata e paqëndrueshme (brishtë) në vend vazhdon të ketë një ndikim negativ në mirëqenien e përgjithshme të komuniteteve minoritare, dhe në të njëjtën kohë rrit perceptimin e tyre për sa i përket faktit se ata nuk kanë siguri të mjaftueshme dhe se e ardhmja e tyre në Kosovë është e pasigurtë (papërcaktuar). Vlerësimi i përgjithshëm mbi gjendjen e sigurisë i përpiluar në periudhën kohore afër kohës kur janë përpiluar edhe raportet tjera paraprake, në Shtator 2000, ishte kategorizuar si e pasigurtë (paqëndrueshme) dhe e përshkuar me një sërë incidentesh siç janë vrasjet, zjarrvëniet, sulmet me granata dhe forma të lehta të frikësimeve që ende paraqesin një ndodhira rutinore për shumicën e pjesëtarëve të minoriteteve. Në të njëjtën kohë, megjithatë, është potencuar edhe shumëllojshmëria për sa i përket përvojave të grupeve të ndryshme minoritare në këtë aspekt. Disa prej komuniteteve në fjalë shihet të gëzojnë një shkallë mjaft inkurajuese të stabilitetit relativ. Trendi i përgjithshëm i dhunës me motive etnike i paraqitur mëposhtë, kur të matet me numrin absolut të vrasjeve dhe lëndimeve serioze, nëpërmjet të ndikimit të përgjithshëm negativ të dhunës sporadike, shihet se nuk është pakësuar fare. Kjo në thelb, paraqet një vazhdim të një shembulli i cili kishte përshkuar gati thuajse tërë vitin 2000.
2. Sidoqoftë, aty kah fundi i vitit 2000 e deri më sot, duke filluar pak a shumë që nga periudha e cila erdhi pas mbajtjes së zgjedhjeve komunale, **deri diku shembulli i dhunës në fjalë nuk kishte ndërruar fare**. Është parë një keqësim i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë dhe pothuajse të gjitha grupet minoritare deri në një masë të caktuar kanë bartur barrën më të rëndë të gjithë kësaj. Numri i incidenteve të drejtuara kah grupet minoritare duket të jetë në rritje e sipër dhe në bazë të ngjarjeve të vitit 2001 në veçanti, sulmet kanë qenë të përshkuara me një organizim dhe ko-ordinim tejet të lartë dhe të drejtuara me kujdes të veçantë gjë që nuk ishte rasti me ato të mëparshmet. Komuniteti rom së bashku me serbët e Kosovës vazhdojnë të figurojnë në mënyrë disproporcionale në mesin e viktimave të krimeve me motive etnike, ku gjithashtu edhe të tjerët nuk kishin mbetur të paprekshëm. Periudha e raportimit ishte e shënuar që prej fillimit të saj me vrasjen e stilit ekzekutues të katër të kthyerve Ashkalinjë në Skenderaj/Srbica<sup>1</sup>, përderisa fundi i saj përshkohej me një seri të sulmeve ndaj rrugëve transportuese të sshfrytëzuara nga ana e minoriteteve për të udhëtuar për në dhe jashtë Kosovës, e cila për kulminacion të vetin kishte sulmin e 16 Shkurtit mbi shërbimin e autobusëve të "Nish Ekspresit" e cila si rezultat kishte vrasjen e 10 serbëve të Kosovës dhe një numër të personave me lëndime serioze. Efekti i kësaj dhune të pazvogëluar fut terror dhe dhunë të paparë në popullatën minoritare. Frika dhe frustrimi i serbëve të Kosovës në veçanti më së miri ishte dëshmuar me protesta gjithëpërfshirëse që u paraqitën pas gjurmëve të sulmit vdekjeprues mbi autobusin në fjalë që ndodhi në mes të Shkurtit. Praktikisht gati i gjithë komuniteti serb i Kosovës ishte ngritur në këmbë dhe ishte skenë e disa formave të protestave, ku shumë rrugë ishin bllokuar për kohë të caktuar, përderisa nëpër disa zona protestat ishin shëndruar në një dhunë edhe më të tmershme. Kemi një cikël konstant të dhunës i cili prodhon dhunë të mëtuajshme përderisa frustrimi mbjell rrënjët e saja edhe në mesin e komuniteteve të tjera, duke përfshirë këtu edhe shqiptarët e Kosovës.

<sup>1</sup> Formula e mëposhtme është shfrytëzuar për sa i përket emrave të vendeve të ndryshme, në shumicën e komunave të banuara me shqiptarë emri në gjuhën shqipe paraqitet i pari përderisa në ato vende ku serbët përbëjnë shumicën e popullsisë emri në gjuhën serbe paraqitet i pari. Kjo është në frymën e Rregullores 2000/43 e cila përcakton (parashikon) edhe përdorimin e emrave në gjuhët e tjera të ndryshme nga ajo shqipe dhe serbe sidomos për komunat ku komunitetet e tjera etnike dhe gjuhësore formojnë një pjesë substanciale të popullsisë.

*Mëposhtë vijon pasqyra kronologjike dhe e pashtershme e cila flet për incidentet e sigurisë të cilat prekin pjesëtarët e minoriteteve sidomos gjatë periudhës kohore gjatë së cilës jemi duke raportuar.<sup>2</sup> Frekuenca dhe llojllojshmëria e incidenteve që kanë ndodhur anembanë krahinës gjatë periudhës kur jemi duke raportuar është e atillë ashtu që ne kemi zgjedhur që thjeshtë të përpilojmë një listë të tyre pa u përpjekur që ti klasifikojmë ato siç ka qenë rasti me raportet e kaluara.*

3. **Tetori**, një muaj ky i cili u karakterizua me një sërë sulmesh mbi pronat e minoritarëve përgjatë krahinës të cilat për shënjestër i kanë si pronat e zëna ashtu edhe ato të braktisura. Më 1 Tetor në veri të Vitisë/Vitina ndodhën 2 eksplozime të cilat shkatërruan një shtëpi pronar i të cilit ishte një serb dhe dëmtuan dy të tjera. Të trija këto prona ishin në proces të shitjes shqiptarëve të Kosovës, pronarët e vërtetë të të cilëve kishin lëshuar Kosovën mëparë. Në ditën e ardhshme, 5 meshkuj të nacionalitetit serb kishin pësuar lëndime kur është hapur zjarr në ta dhe kur një granatë është hedhur mbi ta përderisa një veturë ishte duke kaluar pranë tyre në fshatin Pasjan/Pasjane. Më 4 Tetor ndodhën edhe dy eksplozime të tjera të cilat për shënjestër kishin një pronë të braktisur të një serbi të Kosovës në Zhiti/Zitinje, komuna e Podujevës. Më 7 Tetor një granatë dore ishte hedhur mbi një shtëpi rome në Shtime/Stimlje. Më 10 Tetor ishte hapur zjarr dhe gjithashtu një eksplozim kishte shpërthyer në një shtëpi në Kamanice/Kamenica. Të njëjtën ditë një serb i Kosovës ishte vrarë përderisa ishte duke i kullotur delet e tij në afërsi të Gorne Bitinja/ Biti E Eperme në Strpce/Shterpcë. Më 14 Tetor përsëri ndodhi një sulm me granatë dore e cila për shënjestër kishte po të njëjtën familje rome në Shtime/Stimlje e cila ishte sulmuar gjatë javës së kaluar. Më 15 Tetor një serb i Kosovës së bashku me të birin e tij vdiqën kur me traktor shkelën në një minë tokësore në afërsi të Crkvena Vodica/Palaj në komunën e Obiliqit/Obilic<sup>3</sup>. Më 18 Tetor po e njëjta familje rome në Shtime/Stimlje pësuan sulmin e tretë që kishte ndodhur mbi ta brenda një periudhe kohore prej dhjetë ditësh. Si rezultat i kësaj, një grua dhe një fëmijë i vogël pësuan lëndime përkatëse. Menjëherë pas kësaj familja në fjalë e kishte lëshuar Kosovën për shkak të frikës për jetërat e tyre të cilat iu ishin nënshtruar një sërë sulmeve të pazvogëluara për nga intenziteti gjatë muajve të kaluar. Më 20 Tetor dy granata të dorës ishin hedhur në një lokal të një serbi të Kosovës në Viti/Vitina. Më 23 Tetor ishte shkrepur një mortajë dore në drejtim të një ndërtese në Prishtina/Pristina në të cilën janë të strehuar serbët e Kosovës. Përpos dëmeve të shkatuara në konstruksionin e ndërtesës ky sulm nuk rezultoi me ndonjë person me lëndime serioze. Më 24 tetor një shtëpie të braktisur rome në Rahovec/Orahovec i ishte vënë zjarri e cila në të vërtetë ishte vetëm vijim i një tentimi për zjarrvënienë në po të njëjtën shtëpi më 21 Tetor. Më 25 Tetor një granatë dore ishte hedhur mbi një shtëpi të një serbi të Kosovës në Binaq/Binac, Viti/Vitina. Më 26 Tetor tre granata të dorës ishin hedhur mbi një shtëpi rome në Vushtrri/Vucitrn. Numri i përgjithshëm i vdekjeve të cilat kishin ndodhur gjatë muajit në fjalë është mjaft i vogël duke marrur parasysh numrin e sulmeve me armë të luftës.
4. Numri i të vdekurve në **Nëntor** ishte deri në një masë të konsiderueshme mjaft i lartë pas përderisa praktika e sulmeve të dhunshme kundër personave dhe pronës vazhdoi të jetë i pazvogëluar. Më 2 Nëntor një serb i Kosovës ishte vrarë në tregun e Vitisë. Më 7 Nëntor një grua boshnjake ishte vrarë në shtëpinë e saj në Vitomiricë si pasojë e një fjalosjeje që e kishte pasur djali i saj me disa të rinjë shqiptarë. Më 9 Nëntor trupat e 4 Ashkalinjëve të vdekur u zbuluan në Dashefc/Dashevc në Skenderaj/Srbica brenda periudhës kohore prej 48 orëve pasi që ishin kthyer në fshat. Më 10 Nëntor dy shtëpi rome ishin djegur në fshatin Cerce komuna e Istogut/Istok. Më 11 Nëntor një fëmijë i nacionalitetit rom ishte vrarë në Ferizaj/Urosvec. Më 13 Nëntor një burrë boshnjak ishte sulmuar në Peje/Pec.

<sup>2</sup> Mund të ndodh të kemi përputhje të caktuara me atë çka është thënë në vlerësimet e mëparshme të cilat përfshinin periudhën prej Qeshorit e deri më Shtator 2000 duke përfshirë edhe disa incidente që kishin ndodhur në Tetor për shkak se përpilimi i këtij raporti vazhdoi të përfshijë edhe këtë periudhë për shkak se ishte lëshuar në qarkullim diku kah fundi i Tetorit.

<sup>3</sup> Duhet gjithashtu të ceket se për sa i përket incidenteve me mina të cilët përmenden në këtë raport nuk kanë të bëjnë vetëm me aksidentet me mina në të cilat kishin shkelur pjesëtarët e minoriteteve si pasojë e minave të mbetura nga lufta, mirëpo ajo ngërthen në vete edhe situatat kur shihen indikacionet e asaj se ato mina kanë mundur të montohen rishtazi me qëllim që të godasin popullatën minoritare.

Më 18 Nëntor një granatë e dorës ishte hedhur mbi kopshtin e shtëpisë së një serbi të Kosovës në Rahovec/Orahovac. Një eksplozim masiv i cili kishte ndodhur më 22 Nëntor kishte bërë copa copa shtëpinë e Ambasadorit Vukiçević, një përfaqësues ky i qeverisë jugosllave dhe kryesues i Komitetit Jugosllav për Bashkëpunim me UNMIK-un. Si rezultat i kësaj u vra një pjesëtar i stafit të tij përderisa dy të tjerë pësuan lëndime serioze. Në të njëjtën ditë dy të eksplozime të ndara shkatërruan disa shtëpi të serbëve të Kosovës në fshatin Kllokot/Klokot komuna e Vitisë/Vitina. Më 25 Nëntor personeli i KFOR-it kishte çmontuar një pajisje me natyrë të kurthës eksplozuese e cila ishte ngjitur për derën e një shtëpie rome në Mali Alas/Hallac i Vogel, komuna e Lipjanit/Lipjan.

5. **Dhjetori** nuk pa ndonjë pushim për sa i përket shkallës së dhunës edhe pse numri i të vdekurve figuron të jetë më i vogël se ai i muajve të kaluar. Më 4 dhjetor shpërthimi i një eksplozimi kishte shkatërruar një shtëpi të pabanuar serbe Zhiti/Zitinje, komuna e Podujevës/Podujevo. Po në të njëjtën ditë ishte djegur një shtëpi e banuar me serbë në Lebane, fshat ky i cili ndodhet në komunën e Prishtinës. Më 11 dhjetor një serb i Kosovës vdiq dhe dy të tjerë u lënduan si pasojë e shkeljes së tyre me traktor në një minë tokësore në Suvo Grlo/Suhogerile. Më 12 dhjetor ndodhi një sulm me granatë dore i cili tani kishte për shënjestër një shtëpi serbe në Gjilan/Gnjilane. më 13 dhjetor në apartamentin e tij në viti/vitina u zbulua një serb i lënduar i cili u shpall i vdekur pas arritjes së tij në spital. më 14 dhjetor një eksplozim masiv shkatërroi deri në temel një shtëpi të pabanuar serbe në fshatin Kllokot/Klokot, komuna e Vitisë/Vitina. Po në të njëjtën ditë ndodhën dy eksplozime të ndarë të cilat shkatërruan një shtëpi serbe në Sredske/Sredska në rajonin e luginës së Zhupës, rajon ky i cili gjendet në afërsi të prizrenit. Më 15 dhjetor një burrë rom ishte therrur me thikë në Fushe Kosove/Kosovo Polje. Më 29 dhjetor një çift bashkëshortor serb, të dytë të moshuar, ishin gjetur të shtrirë të mbuluar përplot me gjak para derës së shtëpisë së tyre në Obiliq/Obilic, të cilët më parë ishin rrahur me lopatë. Një burrë i vjetër serb ishte vrarë përderisa një grua tjetër ishte buzë vdekjes pasi që ishin gjetur, mirëpo falë gjetjes së tyre ajo arriti të shpëtojë. Gjithashtu më 29 dhjetor, në Prizren, i ishte vënë zjarri një shtëpie rome.
6. Në **Janar** numri i të vdekurve ishte i vogël mirëpo përderisa numri i incidenteve serioze në këtë drejtim vazhdoi të mbetet i pazvogëluar. Më 12 Janar në afërsi të Fushë Kosovës/Kosovo Polje u gjuajt me gurë në trenin e udhëhequr nga KFOR-i, një ngjarje kjo e cila kishte ndodhur aq herë sa që konsiderohej një rutinë. Më 14 Janar në Shtime/Stimlje iu vë zjarri një shtëpie rome përderisa kjo familje rome nuk gjendej në shtëpi. Më 20 Janar një serb i moshuar në Shtimje/Stimlje ishte kërcënuar nga një person i maskuar gjatë së cilës ai edhe ia vodhi traktorin. Gjithashtu më 20 Janar në fshatin Kmetofc/Kmetovce të komunës së Gjilanit/Gnjilane në kopshtin e një shtëpie të banuar me serbë ishte hedhur një granatë dore e cila si rrjedhojë kishte lëndimin e një gruaje dhe atë nga gurët që fluturonin përreth si rezultat i spërthimit. Më 22 Janar një shtëpi e një serbi të Kosovës në Mogjile/Mogila ishte dëmtuar si rezultat i një eksplozimi të vogël. Më 24 Janar gjithsejt 8 shtëpi serbe ishin dëmtuar në Hoce e Madhe/Velika Hoca nga një sulm me mortajë i dedikuar kundër tyre. Më 26 Janar në Viti/Vitina në sulmin me granatë kundër një dyqani serb u lënduan dy persona. Ishte ky sulmi i gjashtë kundër të njëjtit lokal. Më 27 Janar një serb i Fushë Kosovës/Kosovo Polje ishte therrur për vdekje. Fundi i muajit u shënuar më një shpërthim serioz të dhunës me motive etnike në Mitrovicë/Mitrovica. Një i ri i moshës 15 vjeqare i nacionalitetit shqiptar vdiq më 29 Janar si rrjedhojë e lëndimeve të pësuar nga një sulm me granatë i cili kishte ndodhur në pjesën veriore të qytetit. Kjo vrasje nxiti një sërë protestash të organizuara si nga ana e komunitetit shqiptar ashtu edhe nga ai serb, që si rrjedhojë (pasojë) kishte shpërthimin e një dhune në mënyrën e cila është pa herë e sa herë në Mitrovicë/Mitrovica. Organizatat ndërkombëtare ishin të detyruara që të pushojnë me operacionet e tyre dhe që përkohësisht të tërheqen nga aty përderisa KFOR-i thirrte për përforsime me qëllim të marrjes nën kontroll të situatës. Një incident i cili ndodhi gjatë kësaj periudhe si pasojë kishte rrahjen e stafit të OSBE-së që të gjithë pjesëtarë të minoriteteve, të cilët ishin ndalur nga masa e përbërë prej shqiptarëve të Kosovës përderisa ishin duke udhëtuar për në shtëpitë e tyre me automjet zyrtar.

7. **Shkurti** ishte njëri prej muajve më të errët për një kohë të caktuar e cila u përshkua me një eskalim të ashpër të situatës anembënë Kosovës për sa i përket dhunës së shpërthyer e cila si pasojë kishte ritjen e numrit të të vdekurve. Muaji në fjalë filloi me Mitrovicën/Mitrovica e kapluar nga dhuna ndëretnike e cila gjë edhe kishte udhëhequr rrjedhën e ngjarjeve një javë mëparë para se situata të stabilizohej përsëri. Gjatë vikendit ndërmjet 2 dhe 4 Shkurtit dy shtëpi serbe të braktisura ishin shkatërruar me eksplozim në Gornje Budriga, komuna e Gjilanit/Gnjilane, përderisa e treta ishte sulmuar në të njëjtin fshat mirëpo më 7 Shkurt. Gjithashtu, më 7 Shkurt u sulmua edhe shtëpia e një lideri serb të fshatit Mushnikovo, fshat ky i cili shtrihet në luginën e Zhupës. Më 8 Shkurt një shtëpie të braktisur rrome në Viti/Vitina i ishte vënë zjarri e cila u shkatërrua tërësisht (deri në temel). Po të njëjtën ditë kisha ortodokse e cila ndodhet në Livoq i Epërm/Gornji Livoc, komuna e Gjilanit ishte shkatërruar gjatë shpërthimit të një eksplozimi në atë kishë. Përsëri po të njëjtën ditë ishte shkrepur zjarr kundër një shtëpie rrome në Shtime/Stimlje, e cila për shënjestër kishte një familje e cila ishte sulmuar mëparë në shumë raste. Më 10 Shkurt në Suharekë/Suva Reka ndodhi një sulm me granata dore mbi një shtëpi rrome. Më 13 Shkurt konvoji nën përcjellje e cila udhëton dy herë në javë ndërmjet Strpce/Shterpece dhe vetë Serbisë ishte sulmuar me hapje zjarri nga snajperi gjatë së cilës u vra shoferi serb përderisa një sërë udhëtarësh të tjerë pësuan lëndime përkatëse. Mund të duket se sulmi ishte i dizajnuar ashtu që të shkaktojë dëm maksimal ashtu që duke e goditur shoferin ata kishin qenë në pritje se autobusi do të përfundojë në humnerë, duke vranë dhe lënduar një numër të madh të udhëtarëve. Po në të njëjtën ditë u hap zjarr mbi një serb të Kosovës gjatë së cilës ai kishte pësuar lëndime, rast ky i cili ndodhi në Kllokot/Klokot të Vitisë/Vitina. Gjithashtu më 13 Shkurt tre serb të Kosovës pësuan lëndime serioze përderisa automjeti i tyre shkeli në një minë anti-tank e cila ishte vendosur në rrugën që shpie prej Zubin Potokut për në Skenderaj/Srbica. Njëra prej viktimave ishte evakuuar për në Beograd gjatë së cilës u raportua se ai kishte vdekur si pasojë e këtyre lëndimeve. Më 13 Shkurt, në fshatin Medvece të Lipjanit, ishte shkrepur një bazukë e cila ishte e drejtuar kah një shtëpi rrome. Më 14 Shkurt një trup i pajetë i një burri të nacionalitetit Ashkali ishte gjetur në skaj të rrugës e cila shpie për në Shtimje/Stimlje. Viktima sapo ishte kthyer nga Bosnja me qëllim të gjurmimit për bashkëshorten e tij. Në natën ndërmjet 14 dhe 15 Shkurtit bulonat ishin hequr nga binarët e linjës hekurudhore që lidh Fushe Kosove/Kosovo Polje dhe Mitrovicën/Mitrovica. Shërbimi i trenave, një lidhje transportuese mjaft me rëndësi për vetë serbët e Kosovës, do të rifillojë me punën e saj pas ndërprerjes prej dy javëve e cila u nevojiti me qëllim që të riparohen dritaret të cilat ishin thyer gjatë shpërthimit të dhunës së fundit në Mitrovicë/Mitrovica. Po të kishte kaluar treni nëpër binarët e prishur, atëherë rreziku për të dalur nga to dhe rreziku që udhëtarët të lëndohen jaft seriozisht do të kishte me qenë mjaft i madh. Më 15 Shkurt policia arriti që me mjaft sukses të pengojë një seri të përpjekjeve për të vënë zjarrin nëpër shtëpitë e minoritarëve në Rahovec/Orahovac. Gjatë kësaj ata arritën që të arrestojnë një serb të Kosovës përderisa po përpjekej për ta vënë zjarrin në shtëpinë e një kushëriri të tij edhepse incidentet e ndodhura në muajt e kaluar tregojnë për një involvim të dukshëm të shqiptarëve të Kosovës në këtë aspekt gjë që në fakt rezultoi me arretimin e një shqiptari të dyshuar për raste të tilla. Shtimi i dhunës arriti kulminacionin e vet më 16 Shkurt kur ndodhi sulmi mbi autobusin me udhëtarë i cili barte serbë të Kosovës të cilët deri në atë moment ishin duke udhëtuar nën përcjellje të KFOR-it. Eksplozivi ishte vendosur në skaj të rrugës dhe ishte detonuar në momentin kur po kalonte autobusi i cili ishte në krye të konvojit të Nish Ekspresit. Dy automjete ushtarake të cilat ishin duke e përcjellur këtë konvoj sapo e kishin kaluar atë pjesë të rrugës kur eksplozivi ishte detonuar. Dhjetë njerëz u vranë si rezultat i kësaj masakre (kasaphane), përderisa një numër tjetër i udhëtarëve ishin hospitalizuar pasi që kishin pësuar lëndime mjaft të rënda nga ky eksplozim. Ky sulm shokues ishte njëri prej sulmeve më të rënda që kishte ndodhur në Kosovë për një kohë të caktuar. Pjesa tjetër e muajit nuk u përshkua me ndonjë ulje të nivelit të dhunës. Po të njëjtën ditë, më 16 Shkurt një sërë incidentesh të cilat për shënjestër kishin serbët e Kosovës, kishin ndodhur edhe nëpër zonat e tjera të Kosovës. Një grup të rinjesh të cilët hedhnin gurë si të tërbuar nëpër shtëpitë e serbëve të Kosovës në Lipjan/Lipljan duke thyer Një grup i vogël serbësh të cilët ishin nën përcjellje të KFOR-it dhe ishin duke vizituar varret në fshatin Zahaq ishin gjuajtur me gurë gjatë kësaj vizite. Më 17 Shkurt një eksplozim i cili shpërtheu në një shtëpi serbe në fshatin Mogille/Mogila pothuajse shkatërroi atë shtëpi,

eksplozim ky i cili ndodhi përderisa familja e cila jeton aty nuk gjendej në shtëpi. Më 18 Shkurt dy shtëpi serbe në periferi të enklavës serbe në Rahovec/Orahovac u gjuajtën me kotejë Molotov që si rezultat kishte dëme të shkatëruara në konstruksionet e këtyre shtëpive. Javën e kaluar KFOR-i arriti të pengojë dy meshkuj shqiptarë të cilët ishin munduar që të arrijnë deri në enklavën serbe nëpërmjet të tunel të kanalizimit. Më 19 Shkurt një shtëpi boshnjake në Vitomiricë/Vitomirica ishte sulmuar dhe plaçkitur, përderisa edhe dy shtëpive tjera serbe në Cërkolez/Cerkolez iu ishte vënë flaka. Po të njëjtën ditë në Shtime/Stimlje një shtëpie rome i ishte vënë flaka. Më 20 Shkurt një burrë i nacionalitetit rom ishte sulmuar nga një shqiptar përderisa ky i pari ishte në tregun e Klinës. Më 24 Shkurt një granatë dore ishte hedhur mbi një shtëpi serbe në Viti/Vitina. Kjo ndodhi për shkak se pronari i shtëpisë në fjalë para pak kohe kishte refuzuar ofertën për shitje të shtëpisë. Më 24 Shkurt ndodhi gjithashtu një përpjekje për zjarrvënje ndaj një shtëpie serbe në Rrahovec/Orahovac. Më 24 Shkurt në Fushe Kosove/Kosovo Polje një grua 66 vjeçare serbe ishte goditur për tokë nga një grup të rinjsh ku si rezultat i kësaj ajo humbi vetëdijen. Gruaja në fjalë u detyrua të shtrihet në spital pas këtij tudimi (përvoje keqe). Më 26 Shkurt një shtëpi e braktisur serbe në Kabas/Kabash të Vitisë ishte djegur. Ky muaj përfundoi me vrasjen e një çifti të moshuar bashkëshortor serb në shtëpinë e tyre në një fshat të Kamenicës/Kamenica. Trupat e tyre të pajetë ishin gjetur më 27 Shkurt ashtu të shtrirë në dyshe me të shtëpisë së tyre.

8. Përderisa shumica e incidenteve të paraqitura mësipër ishin të grumbulluara në ato zona të cilat rishtazi kishin qenë shënjestër e sulmeve, lokacionet siç janë Vitia/Vitina, Fushe Kosove/Kosovo Polje dhe Lipjani/Lipljan, ku shumë pak zona kanë mbetur të paprekura nga cikli i dhunës i cili ka kapluar vendin gjatë periudhës sonë të raportimit. Madje edhe ato regjione siç janë ai i Prizrenit, i cili në përgjithësi konsiderohet si deri diku i qetë, u ballafaquan me një rritje të numrit të incidenteve të dhunës të cilat në fakt ilustrojnë situatën e paqëndrueshme (brishtë) dhe natyrën e paparashikueshme të situatës së sigurisë e cila mund të destabilizohet në çdo kohë.
9. Sulmet ndaj rrugëve transportuese, duke përfshirë këtu edhe montimin e qëllimshëm të minave tokësore, sulmet me snajper dhe eksplozimet e ndryshme rezultuan me një numër të madh të të vrarëve. Incidentet e tilla së bashku me ato që nuk janë vdekjepruese siç janë gjuajtjet me gurë, sabotazhet e planifikuara nëpër shina të trenit kanë pasur gjithashtu një ndikim të akumuluar në krijimin e një mentaliteti të shtetrrrethimit. Serbët e Kosovës, në veçanti, tani janë ata të cilët ndihen disi të kërcënuar sidomos në rastet kur të marrin rrugë, madje edhe kur janë nën përcjellje të KFOR-it. Kjo kishte një efekt dëmtues tejet të madh për sa i përket uljes së moralit dhe mirëqenies së popullatës minoritare nëpër tërë Kosovën. Një çështje e cila flet për një kompleksitet të situatës është edhe ajo se shumica e incidenteve kanë ndodhur në afërsi të pikave kontrolluese të KFOR-it. Është shumë me rëndësi që të thirremi në atë se perceptimi i situatës së sigurisë nga ana e minoriteteve nuk bazohet vetëm në numrin e madh të incidenteve. Një faktor tjetër crucial këtu është edhe ndjenja e perceptuar nga ata për sa i përket gjendjes së sigurisë, e sidomos kur komuniteti në fjalë nuk gjendet në kërcënim të drejtëpërdrejtë nga sulmet, sulmet kundër të tjerëve shpeshherë shërbejnë për të shtuar ndjenjën e pasigurisë e cila mbretëron në përgjithësi tek ta. Pasi që kjo ndjenjë të jetë mbjellur në ta, dhe përderisa kërcënimet me dhunë mbetet një fakt që bind, nuk është e nevojshme që të mbahet një intenzitet i lartë i dhunës me qëllim të terrorizimit të popullatës. Krejt çka nevojitet këtu është mbajtja e njëjtë e intenzitetit të aftësisë për të mbajtur nën shënjestër komunitetet minoritare. Duket se kjo aftësi është arritur dhe se në mënyrë të rregullt ushtrohet dhunë ndaj minoriteteve me qëllim të mbajtjes së tyre nën presion. Përpjekjet për të parandaluar një dhunë të tillë nuk kanë pasur nuk po kanë sukses të dalluar në këtë drejtim.
10. Numri që habit dhe llojlojshmëria e sulmeve të dhunshme e paraqitur mëlartë do të bie me rëfimin e pjesës tjetër të këtij rëfimi. UNHCR-ja dhe OSBE-ja mbeten pranë qëndrimit se shumica e sulmeve të dhunshme kundër pjesëtarëve të minoriteteve mbesin të paraportuara. Incidentet e tilla siç janë vrasjet, sulmet me granata dhe eksplozimet janë shumë vështirë që të injorohen. Sidoqoftë, incidentet e lehta të frikësimit siç janë kërcënimet verbale dhe ofendimet, gjuajtjet me gurë, vjedhjet dhe llojlojshmëria e krimeve



të tjera të cilat për shënjëestër kanë minoritetet janë bërë aq vend i zakonshëm për për një klimë të përgjithshme të paligjshmërisë dhe pandëshkueshmërisë e cila e përshkon Kosovën momentalisht se viktimat nuk shohin ndonjë arsye në raportimin e këtyre rasteve. Në disa raste ata i kaplon frika edhe më shumë se me raportimin e tyre ata rrezikojnë një hakmarrje të mundshme nga vetë ata dhe në kuadër të vetë komuniteteve të tyre. Ky keqtrajtim i bërë në mënyrë konstante dhe i pazvogëluar për nga intenziteti ndaj komuniteteve *minortare* minon ndjenjën e tyre të përgjithshme për sigurinë dhe mirëqenien e tyre, dhe si pasojë e kësaj parashtrohet pyetja për të ardhmen e tyre në Kosovë. Situata e paqëndrueshme në jug të Serbisë të cilës i bashkohet edhe fakti për konfliktet e fundit që kanë shpërthyer në IRJM paraqesin gjithashtu faktorë të rëndësishëm të cilët duhet marrur në konsideratë. Jostabiliteti i përgjithshëm të cilën kjo situatë e gjeneron të cilës i bashkohet edhe realiteti i sotëm, dhe potenciali i ardhshëm, për popullatën e zhvendosur brenda përbrenda Kosovës do të thotë edhe më shumë presion i cili bëhet në ta.

## Kthimi

11. Në raportet tona të mëparshme, çështja e kthimit ishte konsideruar si një komponentë përbërëse e një analize më të gjerë e cila përfshin në mënyrë të tërësishme edhe shifrat për popullatën, zhvendosjen dhe kthimin. Është shumë e rëndësishme që çështja e kthimit të konsiderohet Brenda një konteksti më të gjerë me qëllim të ilustrimit të relacionit I cili ekziston ndërmjet të zhvendosjes e cila është duke ndodhur momentalisht dhe kthimit e cila mbështetet në prapavijën e tërësishme të kushteve (rrethanave) me të cilat ballafaqohet popullata e mbetur minoritare. Siç është theksuar në raportet e mëparshme as UNHCR-ja e as OSBE-ja konsiderojnë vetveten si kompetent për të ndërmarrë një rishqyrtim të plotë dhe gjithëpërfshirës për nga madhësia e komuniteteve minoritare të cilat kanë mbetur në Kosovë. Një praktikë (ushtrim) e tillë që në sens është e ngjashme me regjistrimin e popullsisë është jashtë mandatit të secilës prej këtyre dy organizatave dhe është më mirë që një gjë e tillë të ndërmirret nga ana e UNMIK-ut. As që ne jemi në gjendje që ti bijmë në gjurmë të gjitha lëvizjeve të popullsisë. Nor are we able to systematically track all population movements. Ajo çka është ofruar nga ana e raporteve të kaluara paraqet vlersimet më të mira për sa i përket popullatës minoritare në disa prej lokacioneve specifike, të bazuara në disa prej burimeve që i kemi në terren duke i përfshirë këtu edhe përfaqësuesit e komuniteteve në fjalë. Një metodologji e tillë nuk lejon kalkulime përfundimtare për sa i përket numrit të përgjithshëm të secilës prej këtyre grupeve në fjalë. Në pregaditjen e këtij azhurimi që duhet bërë së shpejti, koha dhe kufizimet për sa i përket burimeve me të cilat disponojmë paraqesin një pengesë për rishqyrtimin sistematik të shifrave të popullatës të cilat ishin ofruar mëparë. Sidoqoftë, për shkak se nuk kanë ekzistuar indikacione të qarta që do të bënin me dije për një lëvizje të shkallës së gjerë të popullatës minoritare gjatë periudhës kohore kur është duke u bërë shqyrtimi në fjalë, ne prapëprapë supozojmë se vlerësimet e mëparshme mbeten të vlefshme si direktiva (udhëzime) të përgjithshme.
12. Shembulli i **zhvendosjes e cila është duke ndodhur** siç është vërejtur gjatë periudhës kur jemi duke raportuar ka vazhduar të jetë e një shkalle të ulët i cili për momentin paraqet një dukuri të pandërprerë. Popullatat minoritare janë ende duke e lëshuar Kosovën. Motivimi primar për sa i përket shkuarjeve nga Kosova mbetet i ndërlidhur me çështjet e sigurisë. Shqetësimet e lindura për shkak të sigurisë manifestohen jo vetëm në formë të frikës për sigurinë e tyre fizike por edhe në mënyra të tjera të ndërlikuara duke përfshirë këtu edhe kufizimet në lirinë e lëvizjes dhe qasjen e kufizuar në disa prej shërbimeve elementare dhe mundësive për punësim. Në këto baza shkuarjet e kohëve të fundit nga Kosova mund ti ngarkohen aq sa incidenteve individuale të dhunës aq edhe nënshtrimit pas periudhave të caktuara kohore, të formave të lehta të frikësimit dhe keqtrajtimeve. Mungesa e optimizmit për sa i përket të ardhmes së tyre në Kosovë shikuar në planin afatgjatë është një faktor tejet kontribues në marrjen e vendimit nga ana e tyre për të lëshuar vendin. Incidentet specifike të referuara më lartë në seksionin për sigurinë të këtij rëporti janë të natyrës ilustruese për sa i përket rreziqeve me të cilat minoritetet vazhdojnë që të ballafaqohen. Kur kësaj i bashkohet edhe presioni i cili po iu

bëhet atyre për shkak të jetës që e bëjnë nën kushte tejet kufizuese, nuk është shumë vështirë të shihet se pse kjo zhvendosje ende është duke ndodhur dhe se pse njerëzit janë në mënyrë që mund të arsyetohet janë të brengosur për sa i përket kthimit të tyre.

13. Përpos realitetit të ashpër i cili mbretëron në vend për momentin, ekziston një intenzitet i rritur për sa i përket koncentrimin në çështjet e kthimit gjatë tërë periudhë raportuese. Parimet më të rëndësishme udhëzuese në këtë aspekt vazhdojnë të jenë të përqëndruara në promovimin e krijimit të kushteve për kthim në vend se të promovojmë vetë kthimin. Ekziston një dallim tepër vital ndërmjet këtyre të dyjave, e cila gjë është shumë e rëndësishme që të ceket. Duke u fokusuar në detyrën e krijimit të kushteve të cilat do të mundësonin një gjë të tillë, qëllimi është që të ofrojmë komuniteteve minoritare opzione realiste, kushte këto nën të cilat ata sipas të gjitha gjasave do të vendosnin për tu kthyer duke qenë të sigurtë në njohurinë që iu ofron atyre një zgjedhje afatgjate për sa i përket kategorisë së tyre të zhvendosjes (gjendjes së zhvendosjes). Kjo në mënyrë kualitative është e ndryshme prej prej promovimit të kthimit të tyre e cila në vetvete do të përfshijë përpjekjet e përqëndruara me qëllim të inkurajimit të drejtëpërdrejtë të personave të zhvendosur dhe refugjatëve që të kthehen nëpër shtëpitë e tyre. Një promovim aktiv për kthimin nën kushtet e sotshme do të ishte si të ofroheshon premtime të rrejshme dhe një ndjenjë e rrejshme e sigurisë për popullatën minoritare të cilët ende sot e kësaj dite janë duke u ballafaquar me një rrezik të konsiderueshëm në këtë aspekt. Çka del nga diskutimet e mbajtura kohëve të fundit për sa i përket kthimit është perceptimi i shtuar nga të gjitha palët në këtë drejtim për sa i përket faktit se kthimi paraqet një proces. Ka aq brez (mundësi) për përparim sa ka edhe pengesa të vazhdueshme dhe se vetëm duke u ballafaquar me realitetin dhe duke punuar në bashkëpunim të plotë mund të bëjë që të gjithë akterët e interesuar të çojnë përpara agjendat e tyre në një mënyrë tejet konstruktive duke pasur parrasysh ambientin mjaft kompleks i cili mbretëron në Kosovë.
14. Për sa i përket **serbëve të Kosovës**, bashkësia ndërkombëtare, në bashkëpunim me përfaqësuesit e komuniteteve, i ka përqëndruar përpjekjet e saja në zhvillimin e konceptit se si mund të ndikohet në një kthim të mundshëm të këtyre personave. Nëpërmjet të aktiviteteve më konkrete, është përpiluar një dokument, i cili shtjellon disa prej pengesave kryesore të cilat momentalisht janë duke e bllokuar kthimin dhe gjithashtu potencon masat e nevojshme për krijimin e kushteve për kthim. **Korniza për kthim 2001** e cila rezultoi nga ky dokument përmban një koncenus ndërmjet të përfaqësuesve relevant të bashkësisë ndërkombëtare dhe serbëve të Kosovës për sa i përket qasjes më të mirë me qëllim të çuarjes përpara të kësaj çështjeje. Dokumenti nuk duhet të konsiderohet vetëm si shkresë e cila parasheh një kthim të mundshëm. Sidoqoftë, as që nuk duhet të konsiderohet si thjeshtë si një dokument konceptual teorik. Është një mjet funksionues mjaft i qëndrueshëm në të cilën bazohen aktivitetet e mëtutjeshme dhe më të detajuara të cilat kanë të bëjnë me kthimin e mundshëm të serbëve të Kosovës duke vënë bazat e aktiviteteve të cilat kanë filluar edhe mëparë siç janë vizitat shko dhe shih të gjitha këto të një shkalle të ulët, dhe të cilat iu shkojnë për shtati interesave të personave të zhvendosur.
15. Është shumë me rëndësi që të sigurohet një përshkrim i shkurtë i proceseve që kontribuan në Kornizën e punës në fjalë me qëllim që të eliminojë (mënjanojë) çfarëdo keqkuptimi për sa i përket përmbajtjes dhe qëllimit të saj. Gjatë muajve të vonshëm të vitit 2000 anëtarët e Komitetit të Përbashkët për Kthimin e Serbëve të Kosovës (KPK)<sup>4</sup> i kishin përqëndruar diskutimet e tyre për sa i përket pengesave më të mëdha të cilat qëndrojnë para një kthimi të sigurtë dhe të qëndrueshëm, si dhe fjetëhashtu për masat të cilat nevojiten me qëllim të adresimit sa më të mirë të këtyre pengesave. Anëtarët e KPK-së u pajtuan për të hartuar një kornizë të përbashkët punuese e cila do të luajë rolin e një udhëzuesi për përqëndrimin e të gjitha aktiviteteve të koordinuara që kanë të bëjnë me një kthim të mundshëm të tyre gjatë vitit 2001. Duke punuar në nivel lokal dhe atë

<sup>4</sup> KPK-ja është themeluar në Maj të vitit 2000 me qëllim që të sigurojë një forum punues në kuadër të të cilit do të diskutohen çështjet që kanë të bëjnë me realitetin e kthimit të serbëve. Zyra e PSSP-së, UNHCR-ja, OSBE-ja, elemente të ndryshme të UNMIK-ut (Shtylla II dhe IV), Policia e UNMIK-ut, KFOR-i si dhe Këshilli Nacional Serb kanë bashkëpunuar së bashku gjatë punës së KPK-së. Për detaje të mëtejme referohuni paragrafit 119 të Vlerësimit të Përbashkët të UNHCR/OSBE-së e cila mbulon periudhën kohore prej Qeshorit e deri në Shtator të vitit 2000.

regjional nëpërmjet të 5 Grupeve Punuese Regjionale (GPR), KPK-ja formuloi një kornizë të punës e cila u miratuar me koncensus në mbledhjen e KPK-së më 13 Janar 2001.<sup>5</sup> Kjo kornizë e punës nuk ka për qëllim aq shumë që të përpilojë një sërë qëllimesh operacionale për sa i përket kthimit në fjalë, mirëpo ajo më shumë mëton që të reflektojë parimet themelore të cilat do ta udhëheqin procesin e kthimit si të organizuar ashtu edhe atij spontan të personave të zhvendosur dhe të krijojë mekanizmat koordinues që shërbejnë për mbjelljen e rrënjëve të një procesi të kthimit (dhënies së nisëativave të para “shpjegim i përkthyesit). Në shumë çështje, siç janë të drejtat pronësore dhe qasja ndaj shërbimeve elementare, masat përkatëse u panë si të domosdoshme për kthimin e këtyre personave masa këto të cilat në Vlerësimet paraprake të UNHCR/OSBE-së ishin rekomanduar si nevoja themelore me qëllim të përmirësimit të gjendjes për sa i përket pjesës së mbetur të komuniteteve minoritare.

16. Si një temë qendrore gjithashtu edhe e përsëritur, Korniza në fjalë njeh dhe gjithashtu e pranon në thelb rëndësinë e **dialogut ndëretnik**. Një dialog I tillë për nga nevoja e lindur në këtë aspekt mund të kuptohet si një rrugë dykahëshe, e cila jo vetëm që kërkon një pjesëmarrje aktive dhe të përgjegjshme të komunitetit shqiptar në këtë proces, pra nëpërmjet të liderëve të saj, mirëpo edhe një gatishmëri dhe zellshmëri të shprehur nga ana e komunitetit serb për tu angazhuar në një komunikim konstruktiv dhe ndërtimin e masave të mirëbesimit me shqiptarët e Kosovës nëpërmjet të strukturave udhëheqëse komunale dhe gjithashtu nëpërmjet të homologëve të tyre liderë të komuniteteve të tjera. Rëndësia kritike e angazhimit aktiv dhe pjesëmarrjes së përfaqësuesve të serbëve të zhvendosur, përfaqësuesve të komuniteteve të cilët i kanë pranuar këta persona si dhe pjesëmarrja e liderëve shqiptarë në të gjitha nivelet, në procesin e planifikimit të një krthimi të mundshëm si dhe implementimit është potencuar edhe njëherë këtu. Diskutimet e kohëve të fundit të cilat kanë rezultuar me aprovimin e Kornizës së punës si një dokument pune kanë qenë të mbajtura nga dhe të kufizuara vetëm në përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare dhe ata të komunitetit serb. Si duket, do të jetë më se e nevojshme që ti angazhohmë në mënyrë më aktive edhe sektorët e tjerë të shoqërisë kosovare, sidomos ata shqiptarë si të nivelit lokal ashtu edhe atij qendror. Pëderisa jemi duke potencuar rëndësinë e një dialogu të tillë si një pjesë e një diskutimi më gjithëpërfshirës për sa i përket kthimit, Korniza në fjalë pranon se kthimi është është një e drejtë elementare dhe nuk mund të kushtëzohet me pëlqimin e vetëm një komuniteti apo tjetrit.
17. Me qëllim që të fillojmë një proces të **diskutimeve të gjera** në këtë aspekt, të cilat duhet të përfshijnë akterët kyç në kuadër të shoqërisë kosovare, UNHCR-ja ka inicuar një sërë konsultimesh **me elementë të shquar shqiptarë** me qëllim që t’ju prezentojë atyre Kornizën në fjalë si dhe ti mbrojnë pikëpamjet dhe sugjerimet e tyre në lidhje me atë se si është më së miri të veprohet në këtë drejtim. Pëderisa shqiptarët e Kosovës e pranojnë (njohin) të drejtën për kthim të këtyre personave mirëpo këtë problem ata e lidhin me një sërë çështjesh tjera, e ajo që është më thelbësorja është kthimi I të burgosurve të mbajtur në burgjet serbe, pëderisa ajo që i preokupon ata në planin afatgjatë është statusi i ardhshëm i Kosovës. Ende duhet për tu bërë punë në këtë drejtim me qëllim që të sigurohet që e drejta për kthim, të ketë mundësi që të ushtrohet nga të tjerët në baza vullnetare në siguri dhe me dinjitet. Liderët shqiptarë e kanë të njohur faktin se ata duhet të luajnë një rol të rëndësishëm me qëllim të mbjelljes së kushteve më të mira për një kthim më të favorshëm. Duhet të përqëndrohen përpjekjet nga të gjitha palët me qëllim që të sigurohet që çështja e zhvendosjes së vazhdueshme dhe kthimi i këtyre personave të shikohet nga këndvështrimi i një klime të respektimit dhe tolerancës ndërmjet veti, duke marrur në konsideratë shqetësimet e të gjitha komuniteteve të prekura në këtë aspekt. Suksesi në këtë aspekt nuk do të varet vetëm nga veprimet e shqiptarëve në këtë drejtim mirëpo edhe vullneti i mirë i shprehur nga ana e komunitetit serb për të bashkëpunuar me strukturat administrative në krahinë.

---

<sup>5</sup> Për miratimin e një Kornize të tillë të Punës kishin dhënë pëlqimin si PSSP-ja, i dërguari i posaçëm i UNHCR-së, COMKFOR-i, Kryesuesit e Shtyllës së II, III dhe IV-të, Policia e UNMIK-ut si dhe në fund edhe vetë anëtarët e Këshillit Nacional Serb.

18. Përderisa dokumenti i Kornizës në fjalë koncentrohet në nevojat e personave të zhvendosur serb, dihet fare mirë se ata nuk janë të vetmit që kanë përjetuar zhvendosjen. Nevojat e romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptasve (RAE)<sup>6</sup> kërkojnë vëmendje të barabartë në këtë aspekt. Për çështjen e kthimit të RAE-ve është folur mjaft për një kohë të caktuar. Së pari ishte potencuar me **Platformën për Veprim të Përbashkët, për sa i përket komuniteteve rome, Ashklike dhe Egjiptase të Kosovës**, e miratuar në Prill të vitit 2000. Çështjet thelbësore të cilat kërkojnë një vëmendje të veçantë para se të arrihet ndonjë përparim konkret dhe i qëndrueshëm për sa i përket kthimit të RAE-së, kthim ky i cili ndërlidhet me përmirësimin e kushteve në terren në Kosovë. Komunitetet RAE për momentin janë duke u ballafaquar me probleme të sigurisë, kufizimit të lirisë së lëvizjes dhe kufizime në qasjen ndaj ndihmave elementare dhe shërbimeve publike në këtë aspekt. Diskutimi fokusohet, siç është rasti me kthimin e serbëve, në adresimin dhe tejkalimin e pengesave ekzistuese për një kthim të mundshëm të tyre. Këto pengesa dhe shqetësime kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të ndjekura nga afër nga ana e mekanizmave të cilët kanë dëshmuar të jenë efektive në promovimin e një debati gjithpërfshirës dhe konstruktiv.
19. Procesi në fjalë filloi me organizimin e **Tryezave të Rrumbullakëta Humanitare** të udhëhequra nga UNHCR-ja. Një pjesëmarrje tejet aktive e liderëve politik të shqiptarëve u vërejt në këtë aspekt. Zotimet për sa i përket kthimit ishin të ngërthyera (shtjelluara) në Platformën për Veprim të Përbashkët e cila kërkon në vazhdim përcaktimin e çështjeve kryesore të cilat kërkojnë veprime të përqëndruara të cilat duhet të pasojnë në të ardhmen. Ky zhvillim mjaft pozitiv është çuar një hap përpara nëpërmjet të organizimit të bisedimeve të drejtëpërdrejta ndërmjet liderëve të komuniteteve të RAE-së dhe zyrtarëve të **Strukturave të Përbashkëta të Përkohshme Administrative (JIAS)**. Dy sesione konsultative kanë mbajtur gjer më tani me një pjesëmarrje të liderëve të komuniteteve RAE që vinin nga zonat e ndryshme anembanë Kosovës dhe zyrtarëve të departamenteve të JIAS që për më së afërmi kanë shtjelluar çështjet që brengosin komunitetet RAE siç janë përveç tjerash edhe punësimi, mirëqenia shëndetësore dhe ajo sociale si dhe në fund arsimimi. Ideja e sesioneve të tilla qëndron prapa faktit se duhet lejuar komunitetet RAE që të kenë mundësi që ti parashtrajnë shqetësimet e tyre direkt tek zyrtarët e JIAS dhe të punojnë për së afërmi meta në identifikimin e zgjidhjeve të përshtatshme në këtë drejtim. Sesioni i fundit i këtij lloji është mbajtur më 30 Janar dhe ishte e ndjekur nga 28 përfaqësues të komuniteteve RAE. Pjesëmarrja e gjerë e cila duhet mirëpritur si e krahasuar me atë të mbajtur më 25 Shtator, mbërthen në vetëe edhe një numër të përfaqësuesve të komuniteteve RAE që janë të ko-zgjedhur (kooptuar) nëpër strukturat përkatëse komunale.
20. Një vijë e qartë dhe ndërlidhëse mund të nxjerret ndërmjet aspiratave të komuniteteve RAE me qëllim që të arrijnë qëllimin rreth kthimit të bashkëkombasve të tyre, objektivave të parashtruar në Platformën për veprim të Përbashkët, dhe qëllimit të mekanizmave konsultativ të JIAS për të ofruar zgjidhje praktike për sa i përket atyre problemeve të cilat janë identifikuar si pengesa për një kthim të mundshëm të tyre. Secila prej tyre formon një pjesë të barabartë në përpjekjet e gjera dhe të bashkërenditura me qëllim që të arrihet një përparim më konstruktiv për sa i përket kthimit. Përderisa sesionet e JIAS kanë siguruar një mundësi unike për komunitetet e RAE për ti parashtruar shqetësimet dhe problemet me të cilat ballafaqohen, ato nuk paraqesin një forum i cili do të diskutonte në thelb çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë e këtyre personave. Në njohje të kësaj UNMIK-u dhe UNHCR-ja janë zotuar se do të përkrahin konsultimet e mëtutjeshme të mbajtura sa i përket çështjes së kthimit dhe çështjeve të tjera që kanë të bëjnë me gjendjen e sigurisë. Përfshirja e KFOR-it dhe e policisë së UNMIK-ut në këto diskutime do të jetë esenciale.
21. Për sa i përket punës në terren UNHCR-ja ka vazhduar që ti mbështesë përpjekjet e komuniteteve RAE dhe individëve të tjerë rreth kthimit të tyre. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar rëndësisë së vizitave shko dhe shih Kosovës për të mirën e refugjatëve dhe personave të zhvendosur si mjete që do t'ju lejonin atyre të rivendosin lidhjet e tyre

<sup>6</sup> Si për formulën e miratuar në dokumentet e tjera ne përdorim shkurtesën RAE me qëllim që t'ju referohemi në mënyrë kolektive komuniteteve rome, Ashklike dhe Egjiptase ku referimi iu dedikohet në bazë të nevojës të trijave. Përndryshe ne e specifikojmë grupin etnik nëse dëshirojmë që ti referohemi veçmas.

me komunitetet e tyre. Veprimet e ndërmarrë gjer më tani janë të flakura në nivelin lokal si dhe janë të koncentruara në personat e zhvendosur në IRJM dhe Mal të Zi. Në vazhdim UNHCR-ja dhe OSBE-ja, kanë bashkëpunuar ngushtë me qëllim të fokusimit të vëmendjes së tyre në nevojat e të zhvendosurve RAE brenda përbrenda Kosovës dhe në ata që kërkojnë mbështetje për tu kthyer nëpër komunitetet e tyre (shtëpitë e tyre). Suksesi relativ i masave të tilla pësoi edhe një ngecje të madhe për shkak të vrasjes së katër të kthyerve Ashkalinjë në Skenderaj/Serbice në Nëntor të vitit 2000. Gjatë rrjedhës së vitit 2000 një grup i familjeve Ashkalike, të cilat janë zhvendosur nga rajoni I Skenderajit dhe tani jetojnë në Fushë Kosovë/Kosovo Polje në mesin e qeshorit 2000, kishin kërkuar dhe andaj edhe pranuan ndihmë nga ana e UNHCR-së dhe OSBE-së me qëllim të hulumtimit të mundësive për kthimin e tyre. Me vetë-inisiativë këto familje kishin filluar dialogun me ish fqinjët e tyre duke u përqëndruar në dëshirën e tyre për tu kthyer nëpër shtëpitë e tyre dhe për të rifilluar jetërat e tyre. U bënë një numër i caktuar i vizitave në këtë aspekt, përderisa bashkësia ndërkombëtare iu dha atyre zotime (premtime) konkrete për sa i përket çështjes së dhënies së ndihmave për rindërtim dhe ndihmë tjetër materiale (financiare). Ky proces arriti kulminacionin e tij pas vendimit të marrur nga ana e krerëve të këtyre familjeve për tu kthyer në fshatin e tyre në fillim të Nëntorit, duke pasur vetëbesim se do të fillojnë me rindërtimin e shtëpive të tyre dhe ndoshta edhe të bashkuar me anëtarët e tjerë të familjes mëpastaj. Zbulimi i trupave të pajetë të tyre për më pak se 48 orë pasi që ishin kthyer paraqet një përkujtim që shqetëson për sa i përket rreziqeve sidomos për ato minoritete të cilat dëshirojnë të ushtrojnë të drejtën e tyre për kthim. Valët shokuese të cilat ishin shpërndarë si porosi nga këta vrasës ishin ndjerë në të gjitha komunitetet e ndryshme anembanë Kosovës. Prindërit e Ashkalinjëve në shumë zona filluan që ti nxjerrin fëmijët e tyre nga shkollat për shkak të frikës e cila mbretëronte tek ata në lidhje me sigurinë e tyre. Një vetëbesim i kujdesshëm i lindur si rrjedhojë e punës së mundimshme në këtë drejtim u prish (shlatërrua, shprish) përderisa komunitetet minoritare përpëliteshin për të kuptuar se pse kishte ndodhur ky incident. Shumë prej tyre e kuptuan këtë porosi si një paralajmërim të qartë dhe paekuivoqe drejtuar kthimit të mundshëm të tyre. Sidoqoftë në diskutimet gjithëpërfshirëse të cilat vijuan pas tragjedisë në fjalë, përfaqësuesit e komunitetit Ashkali përsëritën edhe njëherë zotimet e tyre për të vazhduar punën në dobi të kthimit të tyre, pa marrë parrasysh rreziqet që mund të përfshihen në këtë proces. Komunitetet e mbetura të RAE nuk nënçmojnë faktin se ekziston një kërcënim me dhunë dhe si rezultat i kësaj ata nuk parashohin ndonjë kthim të shkallës së gjerë nën kushtet e sotme. Ata janë për një qasje në faza dhe më të kujdesshme për sa i përket çështjes së kthimit dhe për këtë arsye ata shpresat e tyre i kanë tek përkrahja e bashkësisë ndërkombëtare.

22. Ekzistojnë çështje mjaft brengosëse për sa i përket **komuniteteve të prekura nga dukuria e zhvendosjes**. Çështje këto të cilat nxitën ikjen e tyre dhe të cilat edhe për më tepër e pengojnë kthimin e tyre, sidomos dhuna dhe cenimi i të drejtave të tyre më elementare, janë elemente me të cilat ballafaqohen të gjitha komunitetet minoritare pa marrë parrasysh faktin se shkalla dhe pesha (serioziteti) i këtyre incidenteve ndryshon. Për turqit, sllavo-muslimanët dhe goranët nuk ka pasur ndonjë diskutim të strukturuar në lidhje me kthimin e tyre duke e krahasuar atë me atë se çka është ndërmarrë gjer më tani për të mirën e serbëve dhe komuniteteve RAE. Sesionet e organizuara nga JIAS, siç janë mbajtur me përfaqësues të komuniteteve RAE ato gjithashtu janë mbajtur edhe me përfaqësuesit e komuniteteve turke, sllavo-muslimane dhe atë të goranëve me qëllim që t'ju lejohet atyre që të shfrytëzojnë rastin për ti parashtruar disa prej çështjeve më legjitime të cilat i brengosin ata. Sesionet e tilla konsiderohen të jenë një faktor tejet i rëndësishëm drejt nxitjes së njohjes dhe diskutimit të hapur në lidhje me problemet me të cilat ata ballafaqohen, me qëllimin kulminant i cili është gjetja e zgjidhjeve në një klimë të bashkëpunimit ndërmjet të gjithë akterëve të interesuar.
23. Përderisa shqiptarët e Kosovës arritën që të kthehen në vend dhe atë në numër të madh, qështja e kthimit të shqiptarëve të Kosovës nëpër vendet ku ata përbëjnë pakicë për kah numri i tyre, siç është qyteti i Mitrovicës dhe Strpce/Shterpce, ende kërkon një vëmendje të veçantë. Me këtë çështje duhet të merremi ashtu që ta konsiderojmë atë si një pjesë përbërëse e një qasjeje gjithëpërfshirëse e cila në fakt e pranon kthimin e si një pjesë integrale e përpjekjeve gjithëpërfshirëse me qëllim të stabilizimit të gjendjes në

kuadër të komuniteteve të ndryshme në Kosovë, duke iu ofruar të gjithëve gjasa të barabarta për paqe dhe gjasa për një barabartësi. Deri sa të ndodh një gjë e tillë, të gjithë ata shqiptarë të Kosovës të cilët vijnë nga rajonet të cilat banohen nga popullata shumicë serbe, për momentin do të duhet të qëndrojnë të zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës.

24. Përpos përparimit të arritur drejt mbajtjes së një debati më të hapur dhe më konstruktiv për sa i përket kthimit të minoriteteve, faktet tregojnë se është bërë shumë pak për sa i përket tejkalimit të pengesave të cilat pengojnë një kthim të mundshëm të tyre. Dhuna e cila ngjall (shkakton) psiguri vazhdon të jetë e pazvogëluar dhe përpjekjet e konsiderueshme kërkohen të bëhen në këtë aspekt para se komunitetet minoritare të kenë mundësi të realizojnë aspiratat e tyre për kthim. Duke pasur në konsideratë dhe duke iu referuar informatave që kanë të bëjnë me gjendjen e sigurisë e cila është pjesë e këtij raporti, shtetet që pranojnë azilantë janë të alarmuara për shkak të rreziqeve që karakterizojnë përpjekjet e pamatura të tyre për sa i përket shpejtit të kthimit të mundshëm të minoriteteve në Kosovë. Lëvizjet e tilla të marra në këtë drejtim do të mund të rrezikojnë një provokim i cili do të ngjallte një reagim të ashpër nga popullata shumicë e cila do të ndalte çdo përparim të arritur gjer më tani. Mundësia që një numër i incidenteve të ndodhura kohëve të fundit të kenë si qëllim të tyrin parandalimin e drejtëpërdrejtë të kthimit të këtyre personave nuk guxon të anashkalohej.; siç është rasti me vrasësit nga Skenderaji. Ky është një faktor mjaft i rëndësishëm i cili duhet marrur parrasysh sidomos kur jemi duke e vlerësuar faktin se si ti vendosim bazat (temelet) për pregaditjen e një kthimi të mundshëm të minoriteteve në Kosovë.

## Shërbimet shëndetësore

25. **Qasja** ndaj shërbimeve të kujdesit shëndetësor mbetet ende një problem i qëndrueshëm për popullatën pakicë. Është vërejtur në vlerësimet e mëparshme se problemi i qasjes në këtë aspekt është veqanërisht akut kur të flasim për kujdesin shëndetësor sekondar dhe atë terciar. Në krahasim me këtë, sigurimi i kujdesit shëndetësor primar është më pak problematik duke e ditur faktin se kemi një rrjet mjaft të gjerë të ambulanteve (klinikave) në nivelin lokal. Megjithatë, gjithashtu ishte vërejtur se kujdesi shëndetësor primar për pacientët minoritar shpeshherë varet nga ekzistenca e ambulanteve të veçanta për minoritete në kuadër të minoriteteve apo në rastet tjera edhe për komunitetet e izoluar nëpër vendet rurale, që gjithashtu varet edhe nga sigurimi i shërbimeve mobile shëndetësore të cilat mbështeten (përkrahen) nga ana e OJQ-ve. E njëjta gjë vlen edhe për minoritetet që janë të izoluar nëpër lokacionet urbane të cilët janë si të themi të varshme nga thirrjet telefonike të cilat sigurojnë një qasje ndaj shërbimeve shëndetësore. Gjithashtu gjatë raporteve të kaluara janë shprehur shqetësimet për sa i përket qëndrueshmërisë së shërbimeve të tilla komplementare, të cilat nuk janë të inkuorpuara në planin afatgjatë për sa i përket sigurimit të kujdesit shëndetësor. Brengat (shqetësimet) e tilla gjithashtu u shprehën haptazi dhe jehuan gjerë e gjerë nga specialistë mjekësor që vijnë nga rradhët e OJQ-ve të cilët poashtu potencuan faktin se shërbimet e tilla janë tejet të paqëndrueshme. Dyshimet e shprehura kohëve të fundit tregojnë madje edhe për një qëndrueshmëri në planin afatshkurtë dhe atë afatmesëm duke e ditur faktin se një numër i OJQ-ve janë duke i zvogëluar në faza aktivitetet e tyre këtu në Kosovë madje disa prej tyre janë duke e planifikuar edhe largimin e tyre nga Kosova.
26. Rregullorja 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave në Kosovë parasheh dorëzimin (kalimin) e përgjegjësisë për një numër të caktuar të aktiviteteve përkatëse prej nivelit qendror në atë komunal. Në kuadër të aktiviteteve në fjalë, janë të paraqitura përgjegjësitë për sa i përket sigurimit të kujdesit shëndetësor primar. Në pritje të transferimit të përgjegjësisë më 1 Janar, 2001, Departamenti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale hartoi një dokument i cili ka për qëllim të jap përgjegje adekuate ndaj një sërë pyetjesh të parashtruara nga ana e administratorëve komunal dhe autoriteteve të shëndetësisë për sa i përket organizimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor primar në nivel komunal. Qëllimi i Departamentit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale se ky dokument do të shërbejë më shumë si një mjet i përshtatshëm për autoritetet komunale

sesa një udhëzim final i cili u jpet atyre për sa i përket faktit se si duhet organizuar shërbimet e tilla. Në kuadër të kornizës ligjore ekzistuese me një referim për sa i përket udhëzimeve përkatëse të lëshuara nga ana e Departamentit për Administrim Lokal, në bazë të të cilave secila komunë është e lirë që të zgjedhin se çfarë sistemi dëshirojnë.

27. **Kujdesi shëndetësor primar duhet të përfshijë:** *edukimin shëndetësor, sigurinë e ujit dhe higjienën themelore, kujdesin ndaj nënës dhe fëmiut, imunizimin dhe vaksinimin, trajtimin mjekësor themelor, shëndetin mental në kuadër të komunitetit përkatës, kujdesin themelor të gojës dhe furnizimin me barna. Për qëllime të këtij raporti UNHCR-ja dhe OSBE-ja kërkuar për një rishqyrtim të çështjes se a ka pasur ndonjë ndikim pozitiv apo negativ transferimi i përgjegjësisë prej nivelit qendror në atë komunal në sigurimin e shërbimeve për komunitetet minoritare. Duhet të dihet fakti se burimet e UNHCR-së dhe OSBE-së nuk janë të mjaftueshme për të ndërmarrë një revidim gjithëpërfshirës të sistemit të shërbimeve shëndetësore. Çka kemi bërë gjer më tani është se ne thjeshtë kemi mbledhur informata në formë të shembujve prej thujse një numri të kufizuar të lokacioneve ku jetojnë minoritetet. Këto informatë pastaj janë plotësuar me informata të tjera të mbledhura drejtëpërdrejtë nga ana e disa OJQ-ve të cilat sigurojnë shërbime të kujdesit shëndetësor dhe informatave të siguruar direkt nga ana e vetë Departamentit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Sidoqoftë ne jemi të informuar se Organizata Botërore për Shëndetësi është në proces të ndërmarrjes së një shqyrtimi gjithëpërfshirës të qasjes së minoriteteve ndaj kujdesit shëndetësor rezultatet e të cilëve si duket do të kenë mundësi që të jenë më të detajuara se ato që UNHCR-ja dhe OSBE-ja kanë pasur mundësi që ti përpilojnë. Puna që duhet bërë në këtë shqyrtim do të jetë edhe më e avancuar me informatat e mbledhura nga ana e shumë komunave në vend. Disa prej çështjeve që janë marrur parrasysh nga ana e Organizatës Botërore për Shëndetësi paraqesin tregues të qartë për shkallën e qasjes kujdesit shëndetësor primar në kuadër të komunitetit përkatës; kualiteti i kujdesit shëndetësor primar; pasja në dispozicion e pajisjeve laboratorike; ujësjellësit dhe higjienës, dispozicionueshmërinë e transportit emergjent, imunizimin, qasjen ndaj kujdesit shëndetësor gjatë shtatëzanisë së femrave; dhe qasjen ndaj kujdesit shëndetësor sekondar dhe atij terciar.*
28. Në bazë të informatave të mbledhura nga ana e UNHCR-së dhe OSBE-së dhe nëpërmjet të observimit të përgjithshëm të bërë në këtë drejtim mund të thuhet se serbët e Kosovës vazhdojnë të përjetojnë ende probleme tejet akute për sa i përket qasjes ndaj kujdesit shëndetësor në të gjitha nivelet. Pothuajse në të gjitha rastet kjo është e ndërlidhur në mënyrë të drejtëpërdrejtë me sigurinë e tyre dhe problemet e lirisë së lëvizjes me të cilat ballafaqohen ata. Si rezultat (pasojë) i drejtëpërdrejtë i gjithë kësaj mund të pohohet në mënyrë argumentuese se serbët e Kosovës kanë përfituar nga përpjekjet tejet intensive të marra nga ana e bashkësisë ndërkombëtare me qëllim të sigurimit të shërbimeve plotësuese, si për shembull instalimi dhe furnizimi me pajisje adekuate i objektit shëndetësor në Graçanicë/Ulpianë. Komunitetet RAE, supozohet se gëzojnë qasje të mjaftueshme ndaj objekteve të cilat sigurojnë shërbime për shqiptarët e Kosovës. Informatat që vijnë nga terreni, megjithatë, zbulojnë faktin se nuk është gjithmonë kështu dhe kufizimet në lirinë e tyre të lëvizjes të cilave iu bashkohen edhe incidentet e frikësimit dhe keqtrajtimet nëpër klinikat përkatëse mund të nikojnë në mënyrë negative në aftësinë e komuniteteve RAE që në mënyrë efektive të kenë qasje ndaj shërbimeve mjekësore. Në shumë rajone ishte vërejtur se kudo që ekzistojnë shërbimet e ndara (ambulancat fizikisht të ndara) dhe që janë identifikuar se iu shkojnë në dobi shqiptarëve apo serbëve, përderisa RAE apo komunitetet e tjera minoritare janë të lënë mënjanë në këtë proces. Shërbimet duhet të jenë në dispozicion mirëpo akti i thjeshtë me të cilin përfitohet nga shërbimet e tilla mund të interpretohet si një dëshmi e besnikërisë, me gjithë implikimet në situatën e sigurisë që e gjithë kjo mund të lë si trashëgim.
29. **Marrja e përgjegjësisë nga ana e autoriteteve komunale** nuk ka qenë e njëlojtë nëpër tërë Kosovën, përderisa mund të themi se në të ndikojnë një sërë faktorësh. Pas 28 Tetorit, datës kur ishin mbajtur zgjedhjet komunale, themelimi i strukturave komunale ndodhi me një shpejtësi të ndryshueshme e cila në shumë raste varet nga shkalla e koncenzusit dhe mungesa nëpër lokacione të ndryshme. Si rezultat i gjithë kësaj nuk

mund të thuhet se ekzistonte një akt uniform dhe simultan i decentralizimit. Departamenti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale parasheh në mënyrë origjinale një dorëzim gjithëpërfshirës të përgjegjësisë përkitazi me kujdesin shëndetësor primar komunave që prej 1 Janarit 2001. Sidoqoftë, në njohje të vështirësive me të cilat ballafaqohen shumë komuna gjatë marrjes së përgjegjësisë të tyre, datë kjo e cila u shtye për 1 Mars 2001. Në realitet procesi i tranzicionit duket të jetë gradual dhe në zhvillim e sipër, gjatë së cilës ai proces do të ndryshojë (varirojë) përfundimisht nga një lokacion në tjetrin duke u bazuar në rrethanat të cilat mbretërojnë në secilin lokalitet. Kjo gjë vlen për rastet kur shërbimet në fjalë u ofrohen popullatës pakicë, praktikë kjo e cila mund të ndryshojë nëpër secilën komunë veçmas në bazë të akterëve të përfshirë në këtë proces si dhe nevojave specifike të popullatës e cila i shfrytëzon (përfiton) këto shërbime.

30. Sigurimi i edukimit shëndetësor për komunitetet minoritare ka qenë mjaft i ndryshueshëm dhe në një masë të madhe edhe i varur nga përfshirja pro-aktive e OJQ-ve të cilët për momentin janë duke i reduktuar në masë të madhe operacionet e tyre në vend. Departamenti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale parasheh që në planin afatgjatë aktivitetet për sa i përket edukimit shëndetësor do të formojnë një pjesë të një programi përmasash të gjera për tërë Kosovën. Në rast të një skenari të tillë, Instituti Qëndror për Shëndet Publik do të mund të merr përgjegjësinë për temën, planet, metodat dhe materialet të cilat mëpastaj do tu komunikohen komunave nëpërmjet të Organit për Shëndetësi në nivel të qarkut i cili do të mbikëqyr implementimin e saj. Përderisa Departamenti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale vazhdon të përpëlitet me probleme praktike siç janë mirëmbajtja e ambulantave, përparimi i arritur për sa i përket çështjeve siç janë edukimi i përgjithshëm shëndetësor ka qenë mjaft i ngadalshëm dhe nuk ka gjasë që të përmirësohet drastikisht në planin afatshkurtë.
31. Gjithashtu, për sa i përket ujit të pastër dhe higjienës bazike, shumë komunitete minoritare ishin ankuar në lidhje me përqëndrimin e pamjaftueshëm dhe jo të rregullt ndaj këtyre çështjeve dhe gjithashtu ata kishin shprehur shqetësimet e tyre për sa i përket efekteve të mundshme negative në shëndetin e përgjithshëm dhe mirëqenien e këtyre komuniteteve. Duhet të ceket se megjithatë një furnizim i rrallë (i pamjaftueshëm) me ujë dhe higjiena që është nën çdo standard janë disa prej problemeve të cilat mund të ndikojnë pothuajse gati të gjitha komunitetet anembanë Kosovës. Kjo është një rezultat i shumë e shumë viteve të lënies pas dore dhe mirëmbajtjes tejet të dobët të cilës gjithashtu i bashkohen edhe dëmet e shkaktuara si rezultat e luftës së fundit. Kjo nuk do të thotë se komunitetet minoritare ballafaqohen me probleme të tilla si një rezultat i drejtëpërdrejtë i diskriminimit kundër tyre, mirëpo me këto probleme ballafaqohen edhe fqinjët e tyre shqiptarë. Në rastin e komuniteteve RAE u vërejt edhe një problem tjetër si më akut përderisa në disa raste kishte edhe ankesa të cilave nuk iu jepej aq rëndësi si dhe burime të cilat u dedikohen zgjedhjes së problemeve të tilla të cilat në mënyrë primare mund të ndikojnë tek komunitetet RAE.
32. Qasja në kujdesin ndaj nënës dhe fëmijut mund të themi se ndryshon prej një vendi në tjetrin, dhe varet prej grupi minoritar në fjalë. Qasja e tillë bëhet veçanërisht një problem mjaft akut për të gjitha komunitetet minoritare sidomos në rastet kur kemi të bëjmë me lindje të komplikuar dhe kur nëna e cila pritet të lind nevojitet të transferohet në objektin shëndetësor. Gati pa ndonjë përjashtim, komunitetet minoritare bënë me dije se kjo ishte arsyeja e vështirësive me të cilat ballafaqoheshin ata për shkak të një kombinimi të mundshëm të më shumë faktorëve. Në shumicën e rasteve problemi në fjalë ishte i përqëndruar në shqetësimet e lindura për shkak të gjendjes së sigurisë dhe diskriminimit që ishin duke u bërë në spital. Më së shpeshti megjithatë, sfida me të cilën ballafaqoheshin ata paraqitet thjeshtë për shkak të logjistikës për të shkuar deri në spital duke e ditur faktin se kemi të bëjmë këtu me kufizime serioze në lirinë e lëvizjes së shumë komuniteteve minoritare. Në rastin e komuniteteve RAE, të cilët shpeshherë nuk gëzojnë të njëjtën shkallë të qasjes ndaj mjeteve të transportit emergjent sikurse serbët e Kosovës të cilët ruhen prej së afërmi nga ana e KFOR-it, paraqitet më shumë fenomeni i kërkimit të ndihmës për lindjet në shtëpi. Kjo paraqet më shumë një çështje të nevojshmërisë sesa që është një çështje e zgjedhjes nga ana e tyre. Në shumicën e rasteve rutinore të cilat nuk përmbajnë në vete ndonjë aspekt të komplikimeve që kërkojnë intervenim të shpejtë, shumica e komuniteteve raportuan për një qasje të



kënaqshme ndaj shërbimeve materiale mirëpo siç është vërejtur se si edhe shërbimet e tjera mjekësore ashtu edhe këto shpeshherë sigurohen në mënyrë veqese (ndarëse) siç është për shembull njësia e maternitetit në qendrën mjekësore të Gracanicës/Ulpianë e cila funksionon për serbët e Kosovës.

33. **Shërbimet e imunizimit dhe vaksinimit për shumë komunitete minoritare vazhdojnë deri në një masë të madhe të varen nga përfshirja e akterëve të OJQ-ve në këtë drejtim.** Në bazë të organizimit të tanishëm në këtë aspekt mund të na del se asnjë sektor i popullatës nuk ka mbetur pa kujdes të duhur në këtë aspekt nëpërmjet të fushatës së vaksinimit të mbajtur gjer më tani. Sidoqoftë, DSHMS pranon (njeh) se njësitë mobile të cilat në një mënyrë janë të varshme nga përkrahja e bashkësisë ndërkombëtare janë një mënyrë e shtrenjtë e udhëheqjes së shërbimeve të tilla dhe në të ardhmen ajo në mënyrë komplete duhet të bie në duart e secilës komunë si një pjesë e shërbimeve normale mjekësore të kujdesit shëndetësor. Mbetet të shihet se si nevojat e komuniteteve minoritare do të mund të inkorporohen në një sistem të lokalizuar.
34. **Shërbimet mjekësore të shëndetit mental në kuadër të secilit komunitet në bazë të pranueshmërisë nga ana e DSHMS janë mezi thuajse ekzistente duke u krahasuar me sferën e ndihmave të cilat sigurohen nga ana e OJQ-ve ndërkombëtare në këtë fushë.** Zbratësira e cila ekziston në shërbimet e tanishme mjekësore është ajo e cila ndikon si në popullatën pakicë ashtu edhe atë shumicë. DSHMS ka për qëllim që të zhvilloi një program të kujdesit për shëndetin mental në kuadër të secilit komunitet, program ky i cili përfundimisht do të bie nën juridikcionin e organeve komunale për ta implementuar. Mungesa serioze për psikiatra dhe psikologë të trajnuar ka ekzistuar dhe vazhdon të ekzistojë edhe më si një pengesë në këtë aspekt. Është mëse e qartë se kushtet shqetësuse me të cilat ballafaqohen komunitetet minoritare gjenerojnë një brez të gjerë të problemeve nga sfera e shëndetit mental, të cilat i bëjnë shërbimet e llojit të tillë si mëse të nevojshme.
35. **Furnizimi me barna themelore mëparë ka qenë i mbikëqyrur nga ana e OJQ-ve ndërkombëtare, siç është Pharmacens sans Frontiers, mirëpo që nga tërheqja e tyre nga Kosova në fillim të Janarit 2001, kjo përgjegjësi ka kaluar në duart e Kooperativës Farmaceutike të Kosovës (KFK). KFK-ja është një organizatë hibride; shikuar nga njëra anë ajo paraqet një pasaardhëse të asaj çka ka mbetur nga sistemi farmaceutik i shtetit të mëparshëm, ndërsa në anën tjetër ajo paraqet një lloj të OJQ-së.** Për shkak se është themeluar kohëve të fundit ajo është e dominuar kryesisht nga shqiptarë dhe disa komunitete të tjera minoritare janë ankuar se furnizimi i tyre me barna është i ndikuar negativisht si pasojë e gjithë kësaj. KFK-ja është e autorizuar dhe e paguar nga ana e DSHMS për të siguruar furnizimin dhe shpërndarjen e barnave të gjitha komuniteteve pa diskriminim në baza të etnicitetit apo në çfarëdo baze tjetër. Momentalisht KFK është duke u ballafaquar me një sërë vështirësish praktike dhe logjistike sidomos në sigurimin e furnizimit me barna të atyre zonave ku jetojnë minoritetet, stafi i të cilëve janë të pasigurtë që të udhëtojnë. Si rezultat i gjithë kësaj lindi nevoja që organizatat ndërkombëtare të përfshihen në furnizimin dhe shpërndarjen e barnave me qëllim që të sigurohet që popullatës pakicë tu jipet kujdes i veçantë. KFK-ja ka arritur një marrëveshje me një organizatë ndërkombëtare me qëllim që të plotësojë brezin e qasjes së saj ndaj komuniteteve minoritare. Një marrëveshje e tillë është e vlefshme deri në Qeshor 2001 pas të cilës periudhë kohore KFK-ja do të detyrohet që të sigurojë se shërbimet të cilat ata i ofrojnë do të përmbushin të gjitha nevojat e komuniteteve minoritare. DSHMS shpreson të ndihmojë në kapacitetin e KFK-së me qëllim të përmbushjes së obligimeve të tyre nëpërmjet të mbrojtjes së idesë së përfshirjes së drejtëpërdrejtë të pjesëtarëve të minoriteteve në udhëheqsinë e KFK-së. Si shumë aspekte të tjera të cilat përshkojnë shërbimet mjekësore, edhe ky aspekt do të jetë një proces delikat i negociimit edhe pse shihet të ketë mungesë dëshire për një bashkëpunim nga të dyja anët pasojë kjo e mungesës së mirëbesimit të ndërsjellë. Përvojat tona për sa i përket KFK-së gjer më tani tregojnë për një llojllojshmëri të problemeve të cilat sipas të gjitha gjasave do të mund të lindin për shkak të faktit se sistemi i kujdesit shëndetësor është kryesisht i "kosovarizuar". DSHMS do të duhet të jetë i alarmuar në mënyrë konstante ndaj problemeve të cilat mund të lindin si dhe të jetë i hapur për gjetjen e zgjidhjeve funksionale, duke qenë të

vetëdijshëm për faktin se zgjidhjet e tilla do të mund të kenë implikime shtesë burimore në planin afatshkurtë dhe atë afatmesëm.

36. Shkalla e përfshirjes së **punëtorëve shëndetësor që vijnë nga rradhët e minoriteteve** është përgjithësisht e ulët me përjashtimin e pjesëtarëve të komunitetit serb nga gjithë kjo. Disa prej institucioneve të cilat u ofrojnë shërbime adekuate pjesëtarëve të komunitetit serb vazhdojnë të jenë kanë shumë anëtarë të stafit të tyre saqë punëtorët shëndetësor janë koncentruar në një numër të kufizuar të lokaliteteve gjeografike si rezultat i drejtëpërdrejtë i zhvendosjes së tyre. Kjo mund të rezultojë në situatat në të cilat shtëpia e shëndetit me një objekt relativisht të vogël përmban në stafin e vet mëse 100 infermiere dhe 4 doktorë të cilët punojnë me ndërrime<sup>7</sup>. UNMIK vazhdon me përpjekjet e tyre për të inkorporuar punëtorët shëndetësor serb në sistemin e përgjithshëm shëndetësor, sidomos nëpërmjet të zgjatjes së kontratave dhe rritjes së pagave. Sidoqoftë, kjo paraqet një dilemë për vetë punëtorët shëndetësor të cilët janë të merakosur për faktin se do të mund të humbin vjetërsinë në punë (stazhin) si dhe të drejtën e pensionit të akumuluar si rezultat i punës së vazhdueshme të tyre në sistemin shëndetësor shtetëror. Ende është realitet se disa punëtorë shëndetësor mbeten duke punuar jashtë sistemit të UNMIK-ut dhe në vend të kësaj ata kanë kontratë dhe i pranojnë pagat e tyre direkt nga autoritetet qëndrore në Beograd. Ekzistojnë raporte të cilat vazhdojnë të vijnë edhe sot e kësaj dite se disa punëtorë janë nën presion të autoriteteve qëndrore, të cilëve ata thjeshtë iu referohen si “Beogradi” duke mos specifikuar ndonjë burim të veçantë në këtë aspekt, në mënyrë që ata punëtorë të rezistojnë bashkëpunimin me UNMIK-un. Në vazhdim ata mund të ballafaqohen me presione që vijnë edhe nga rradhët e komunitetit të tyre të cilët bashkëpunimin me UNMIK-un e shohin si një tradhti. Çështjet e tilla do të duhet të shqyrtohen në mënyrë realiste dhe me përgjegjësi nëse natyrisht UNMIK-u që të zhvillojë një sistem gjithëpërfshirës të kujdesit shëndetësor e cila do ti përmbushte nevojat si të pacientëve ashtu edhe të punëtorëve shëndetësor.
37. **Spitali i Mitrovicës** i cili menaxhohet kryesisht nga ana e serbëve vazhdon të paraqes një shembull të dukshëm të polarizimit për sa i përket sigurimit të kujdesit shëndetësor (shërbimeve mjekësore). Një rezultat mëse i dukshëm në këtë rast është se shqiptarët e Kosovës janë ata të cilët përfundojnë si të përjashtuar dhe të diskriminuar nga e gjithë kjo. Për ta spitali mbetet jashtë caqeve të tyre, më së shumti për shkak të arsyeve të sigurisë, dhe për faktin se ata janë të detyruar që të udhëtojnë diku tjetër në mënyrë që të kenë qasje ndaj shërbimeve mjekësore. Rastet e izoluara dhe ato të ndjeshme të cilët jetojnë në pjesën veriore të qytetit dhe të cilët janë në pamundësi që t’ju qasen me lehtësi objekteve medicinale që gjenden në jug të qytetit, kërkojnë një vëmendje të veçantë. Për momentin një numër i madh i organizatave ndërkombëtare kanë themeluar një sistem ad-hoc të vizitave shtëpiake. Sidoqoftë në këtë çështje më së shumti ndikim ka ndërrimi i gjendjes së tërësishme të sigurisë dhe në fakt nuk ofron ndonjë sistem efektiv dhe të qëndrueshëm shikuar në planin afatgjatë për sa i përket përmbushjes së nevojave të këtyre pacientëve.
38. Qasja ndaj **shërbimeve spitalore** kudo në Kosovë vazhdon të jetë një problem i madh i cili ndikon tek komunitetet e ndryshme minoritare në shkallë të ndryshme. Përderisa ekzistojnë shembuj pozitiv në këtë aspekt siç janë raportet e pranuar nga ana e komunitetit Egjiptas i cili është i koncentruar kryesisht në Kosovën perendimore për sa i përket kënaqësisë së tyre me marrëveshjet e kohëve të fundit të arritura me qëllim të sigurimit të qasjes ndaj shërbimeve spitalore<sup>8</sup>, komunitetet minoritare nëpër lokacione të

<sup>7</sup> Ne nuk mendojmë që të sugjerojmë se është i domosdoshëm fakti se kudo që këto koncentrimet ndodhin të gjithë ofruarit e shërbimeve mjekësore duhet të përfqishen në listën e pagave të UNMIK-ut. Shumë prej tyre mund të zgjedhin që vazhdojnë të punojnë pa pagesë apo të paguhet nga burime të tjera. Çështja këtu qëndron se shumë ofruarit të shërbimeve në fjalë janë të fokusuar në një zonë përderisa zonat e tjera mbeten relativisht me një nivel më të ulët të kujdesit shëndetësor. Kjo dukuri fatkeq është një pasojë e drejtëpërdrejtë e zhvendosjes në fjalë.

<sup>8</sup> Duhet të ceket se përderisa liderët e komunitetit Egjiptas kanë shprehur kënaqësinë e tyre karshi qasjes jodiskriminuese ndaj objekteve shëndetësore në Kosovën Perendimore, ku gjithashtu ata kishin shprehur brengosjet e tyre për sa i përket faktit se pjesëtarët e komuniteteve të tyre ende ballafaqohen me probleme të lirisë së lëvizjes. Ky faktor në mënyrë efektive i pengon ata në qasjen e tyre të plotë dhe të lirë ndaj shërbimeve në fjalë. Do të jetë ende vështirë ose të themi edhe e pamundur për shumë egjiptasë të Kosovës Perendimore që të udhëtojnë të papenguar për në Prishtinë me mjete të transportit publik me qëllim që të kenë qasje ndaj shërbimeve që ofrohen në

ndryshme mbeten mjaft të shqetësuar për sa i përket sigurisë së tyre nëpër spitale. Në Prizren, për shembull, vend ky prej të cilit ne raportuam për përpjekjet e lavdërueshme për të siguruar qasje adekuate për pacientët minoritar, një pacient serb u detyrua që të evakuohej nga spitali publik për shkak të problemeve të sigurisë që mbretëronin në atë spital. Pacienti u transferua për në spitalin e Prizrenit pas të cilit pasoi intervenimi kirurgjik në spitalin fushor të KFOR-it. Shumë shpejtë pas arritjes së tij në spitalin publik në fjalë u pranua një thirrje telefonike për një kërcënim të mundshëm me bombë e cila paraqiti nevojën e evakuimit të të gjithë pacientëve nga ai spital. Kjo rezultoi me kërkesën e bërë Kryqit t'q Kuq të Belgjikës nga stafi i spitalit dhe KFOR-it me qëllim të evakuimit të pacientit në fjalë. Ai ishte transferuar mëpastaj nëpërmjet të Prishtinës për në një spital në vetë Serbinë mirëpo fatëkeqësisht ai vdiq shumë shpejt mëpastaj. Gjithashtu në rajonin e Gjilanit, raportohet për një shkallë të ngritur të vetëbesimit në anën e pacientëve serb përkitazi me shfrytëzimet e shërbimeve të spitalit, mirëpo vdekja e pacientit serb në fjalë në mesin e gjithë atyre pohimeve të cilat flasin për një kujdes të dobët mjekësor i cili paraqet një faktor kontribues, dëshmoi të ishte një ndalesë (pengesë) në këtë aspekt. UNMIK-u dhe OJQ-të që së bashku punojnë në fushën e kujdesit shëndetësor në këtë zone, mbesin të zotuar për idenë e shfrytëzimit të përbashkët të objekteve shëndetësore dhe duke pasur parrasysh këtë fakt, pacientët serb janë të inkurajuar në mënyrë aktive që të shfrytëzojnë spitalin gjatë së cilës ata do të jenë edhe më të lehtësuar në këtë aspekt pas marrjes së masave speciale të sigurisë. Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK) ka zgjeruar programin e saj të ndihmave për sigurimin e përcjelljeve të pacientëve për në spital. Përderisa kjo ende paraqet një realitet mjaft të ashpër ashtu që përcjelljet e sigurisë kërkojnë edhe një involvim të SHPK-së, kjo gjë shënon një hap të vogël të bërë drejt një praktike më funksionuese dhe mundësisht më të qëndrueshme për shkak se mbërthen në gjirin e saj edhe një numër të akterëve vendor që është më mirë se që të mbështetemi plotësisht në ndihmën e KFOR-it.

39. **Departamenti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale** mbetet i zotuar ndaj qëllimit për një sistem shëndetësor të integruar plotësisht i cili i plotëson nevojat e të gjithë kosovarëve pa marrë parrasysh përkatësinë e tyre etnike. Në Dhjetor të vitit 2000, u themelua Zyra për çështje të minoriteteve në kuadër të Departamentit në fjalë me një pjesëtar të stafit ndërkombëtar të cilit i është dhënë detyra që të ndjek brengat e popullatës minoritare. Me qëllim të arritjes së një shërbimi korrekt në këtë drejtim, me theks të veçantë në këtë aspekt janë dy çështje: pjesëmarrja, e cila mund të realizohet nëpërmjet të punëtorëve minoritar të inkuadruar në sistemin shëndetësor, dhe qasje për tërë pacientët. Realiteti, megjithatë, flet për brenga që lindin për shkak të gjendjes së sigurisë, të cilat gjithashtu janë të kombinuara me një perceptim për sa i përket diskriminimit, e cila vazhdon të qëndrojë si pengesë ndaj një përparimi konstruktiv i cili duhet bërë në këtë aspekt. Një nevojë mjaft e qartë, veçanërisht për shkak se tani përgjegjësia për kujdesin shëndetësor është e decentralizuar, është se DSHMS duhet të luajë rolin e monitoruesit dhe duhet të themelojë mekanizma të shpejtë dhe efektiv me qëllim të sigurimit që ankesat specifike për sa i përket diskriminimit në sferën e kujdesit shëndetësor duhet të mirren plotësisht në considerate, gjatë së cilës gjithashtu duhet marrur masa të nevojshme në këtë drejtim.
40. Marrja e **masave të përkohshme speciale** paraqet një mjet mjaft të përshtatshëm për të siguruar që shërbimet të cilat i kemi në dispozicion të kenë mundësi të përgjigjen të gjitha nevojave reale të njerëzve të zakonshëm. Sfidë këtu mbetet fakti se duhet siguruar që masat e tilla të përkohshme të mos rrënohen, fakt ky i cili përbën një status quo të papranueshme e cila do të jetë e vështirë që të zërthehet në të ardhmen. OJQ-të kanë luajtur një rol tejet të rëndësishëm për sa i përket potencimit të brengave të cilat na preokupojnë në këtë aspekt. Me pregaditjen e OJQ-ve për ta lëshuar Kosovën, ato me këtë kanë dhënë një paralajmërim të qartë DSHMS-së për zbrastësirat të cilat mund të lindin gjatë sigurimit të shërbimeve në fjalë. DSHMS njuh nevojën për mbushjen e këtyre zbrastësirave dhe në këtë drejtim është duke bashkëpunuar ngushtë me OJQ-të për të siguruar një tranzicion sa më të lehtë pas tërheqjes së këtyre shërbimeve nga Kosova.

---

spital. Një faktor kufizues në këtë aspekt mbetet siguria e përgjithshme e cila shkakton kërcënim tek komunitetet minoritare kur të lëvizin nëpër vendet publike.

Sigurimi i kujdesit shëndetësor në baza të drejta për të gjithë banorët e Kosovës mbetet një sfidë tejet gjigante për bashkësinë ndërkombëtare dhe se gjer më tani është i njohur fakti se bashkësia ndërkombëtare i është larguar zgjidhjeve të lehta.

## Prona

41. Deri më tani nuk është vërejtur ndonjë përparim i dukshëm për sa i përket gjendjes së pronave të minoriteteve që prej kur vlerësimet e mëparshme janë përpiluar. Fushat kryesore të brengosjes mbeten: qasja për minoritetet ndaj një sistemi efektiv me qëllim të marrjes së vendimeve për sa i përket kërkesave pronësoro-juridike; pohimet për okupim të paligjshëm të tyre; ndërtimi i paligjshëm në pronat e minoriteteve; qasja ndaj ndihmës për rindërtim; dhe dukuria e “shitjeve strategjike”. Së voni në veçanti, ekziston një brengë e shtuar e cila ka arritur përmasa alarmuese në kuadër të disa komuniteteve dhe është perceptuar nga ana e komuniteteve minoritare si një metodë tjetër për ti larguar ata nga Kosova.

### Shitjet strategjike

42. Asaj çka i referohemi si “shitje strategjike” e pronave të minoriteteve mund të definohet si praktikë ku pronarët minoritar të pronave, të cilat gjenden në lokacione të rëndësishme strategjike në kuadër të zonave të banuara me minoritar, janë të shtyer që ti shesin pronat e tyre, si pjesë e një fusahate e cila duket të jetë e organizuar<sup>9</sup>. Shtyerja (nxitja) për të shitur mund të jetë e ndërlidhur me kërcënime me dhunë. Kjo shtyerje (nxitje) mund të jetë thjeshtë në formë të ofertave për blerje me një çmim shumë më të lartë se çmimi i cili sillet në treg, mirëpo e cila duket të jetë një pjesë e një plani më të gjerë për ti blerë pronat në fjalë, plan ky i cili do të dobësojë komunitetet minoritare që kanë mbetur në vend. Duke pasur parrasysh numrin e shtuar të raporteve për sa i përket trendit të tillë i cili mbretëron nëpër vende të ndryshme, ne jemi përpjekur që të shqyrtojmë, me një trend sa më shumë sistematik që është e mundur, informatat që i kemi pranuar në lidhje me të ashtuquajturat shitje strategjike. Duhet të ceket që nga fillimi se çështja e shitjes së pronave të minoritarëve, qofshin ato të llojit strategjik apo tjera është temë e një debati mjaft intenziv. Ekzistojnë disa prej liderëve të komuniteteve të cilët e kuptojnë këtë gjë si një prioritet urgjent me qëllim të ndalimit të shitblerjeve në fjalë, që mund të perceptohet si një mjet për mbrojtjen e të mirave të popullatës së mbetur. Në anën tjetër shitja e pronave individuale mund të shihet nga ana e pronarëve si e drejtë e tyre apo si mjet për të siguruar burime të mjaftueshme financiare me qëllim të rivendosjes së tyre në Serbi apo diku tjetër.

43. Është shumë vështirë që të gjykohet e tërë shkalla (intenziteti) i të ashtuquajturave “shitje strategjike” të cilat janë duke ndodhur për momentin. Së pari, është shumë vështirë që të fitohen dëshmi të drejtëpërdrejta në lidhje me ndonjë organizatë e cila qëndron prapa këtyre blerjeve. Për më shumë, mund të thuhet se është shumë vështirë që të vërehet dallimi ndërmjet sulmeve të përgjithshme mbi minoritetet, e cila ka efektin e saj të provokimit të shkuarjes së tyre nga Kosova, prej kërcënimeve speciale të dizajnuara që të kenë për shënjestër të gjithë pjesëtarët e minoriteteve me qëllim që ti largojnë ata nga vendet të cilat konsiderohen si vende strategjike. Në një mori lokalitetesh ku jetojnë minoritetet, janë vërejtur shumë raste të frikësimit të atyre shqiptarëve të cilët kishin shprehur dëshirën për ti blerë pronat e serbëve, për arsye se disa sektorë të komunitetit të tyre pohojnë se për shkak se serbët nuk kanë të drejtë ndaj këtyre pronave andaj nuk ka nevojë edhe për ti blerë.

---

<sup>9</sup> Nacioni lokacion strategjik nuk është gjithmonë i definuar lehtë për shkak se ndërlidhet me perceptimin e saj nga ana e komuniteteve minoritare. Kjo duhet të kuptohet si një gjë e cila duhet të përfshijë pronat të cilat lidhin apo bashkojnë grupe të shtëpive minoritare në mes veti apo me shërbime të tilla siç janë dyqanet apo klinikat. Fakti se shitja e pronave të tilla do të mund të rezultojë me reduktimin (zvogëlimin) e numrit të banorëve minoritarë që i popullojnë ato zona, duke i detyruar ata që të kalojnë në zonën shumicë, është një bazë e rëndomtë sipas të cilave komunitetet në fjalë i klasifikojnë pronat e caktuara si strategjike.

44. Megjithatë, nëpër disa lokacione paraqiten edhe dëshmi të cilat tregojnë për një shënjestrim të lokacioneve të tilla strategjike. Për shembull, në një ndërtesë në Prishtinë ku janë të koncentruar serbët e mbetur (të cilët posedojnë një mbrojtje të zgjeruar nga ana e KFOR-it), ka përpjekje insistuese nga ana e shqiptarëve për ti blerë pronat e serbëve që ndodhen në atë ndërtesë. Edhe pse shqiptarët e Kosovës janë penguar gjer më tani prej KFOR-it për ti okupuar këto prona, disa blerës të mundshëm të këtyre pronave informuan OSBE-në se arsyeja prapa kësaj qëndron në faktin se kjo do të shpejtojë shkuarjen e serbëve të tjerë të mbetur. Këta blerës të mundshëm thanë se besojnë që posa të hyjnë disa prej shqiptarëve në atë ndërtesë, atëherë KFOR-i do të reduktojë shkallën e mbrojtjes ndaj serbëve.
45. Vëllimi i informatave të cilat bëjnë me dije për blerje të mundshme apo shitje të detyruara të pronave të serbëve, janë grumbulluar vetëm nga rajoni i Prishtinës. Ankesat e mëparshme të parashtruara përkritazi me këtë dukuri janë në masë të madhe të kufizuara vetëm nëpër qytete, edhe pse kjo periudhë kohore përshkohet me një shtrirje të indikacioneve që bëjnë me dije për ndodhjen e asaj çka mund të quhet blerje strategjike (me çmime më të larta se që sillen në treg) e pronave të serbëve, në lokacionet kyçe në afërsi të Prishtinës. Në Obiliq, komuniteti serb i zvogëluar në numër ka qenë dëshmitar i shënjestrimin të qëllimshëm të këtyre lokacioneve kyçe (si për shembull prona e cila gjendet në zemër të komunitetit, apo edhe në lokacione të tjera kyçe të cilat janë me rëndësi vitale për ndjenjen e mirëqenies së komunitetit). Sipas komuniteteve minoritare transferi i pronësisë së tillë rezultoi me një rritje të pasigurisë. Blerje të tilla sistematike të pronave në fjalë janë vërejtur gjithashtu edhe në zonat e banuara me serbë të komunës së Lipjanit
46. Një shembull shtytës i kësaj dukurie vazhdon të jetë i përqëndruar në zonat e banuara me serbë në komunën e Fushë Kosovës. Dukuria e tillë (mostër) duket të jetë mjaft e shprehur në këtë aspekt, gjatë së cilës OSBE-ja arriti të dokumentoi një numër të caktuar të rasteve të tilla. Komuniteti serb i Kosovës e përshkruan përvojën e tij në këtë drejtim si vijon: Blerësit e mundshëm shqiptarë vijnë dhe i vizitojnë shtëpitë e serbëve duke iu ofruar atyre çmim përkatës për pronat në fjalë. Nëse një serb i Kosovës refuzon ofertën për blerje, shtëpia mëpastaj gjuhet me gurë, përderisa blerësit e mundshëm paraqiten mëpastaj me çmim më të ulët. Nëse pronari edhe këtë herë e refuzon ofertën në fjalë, shtëpia përsëri gjuhet me gurë përderisa pronari tani fillon të pranojë edhe thirrje telefonike dhe ka mundësi që të sulmohet edhe fizikisht. Në secilin prej këtyre rasteve, blerësit e mundshëm janë persona të rinjë, të sjellshëm, të cilët thjeshtë nuk këmbëngulin që gjithsesi ta blejnë atë, mirëpo ata thjeshtë vetëm e prezantojnë ofertën e tyre. Çmimet e ofruara ndryshojnë (variojnë) prej një lokaliteti në tjetrin në kuadër të një qyteti. Çmimi më i lartë ofrohet për shtëpitë që gjenden në mes të rrugëve serbe, dhe për ato që gjenden në rrugët kryesore, të cilët përfitojnë nga qasja e mirë dhe patrullimet e KFOR-it. Shtëpitë e mbetura mëpastaj kanë gjasë që të shiten me një çmim edhe më të ulët, për shkak se pronarët e këtyre shtëpive frikësohen të jenë të rrethuar nga vetë shqiptarët. Si rezultat i shitjes së vazhdueshme të shtëpive që janë në pronësi të serbëve në qytezën e Fushë Kosovës, pronat që ndodhen përgjatë rrugëve kryesore tani thuajse janë në pronësi të shqiptarëve, përderisa serbët jetojnë nëpër lagje të vogla, të cilat edhe mëtej shënjestrohen. Kur ekziston vetëm një shtëpi serbe në kuadër të një lokaliteti, atëherë ekziston tendenca që ajo shtëpi të gjuhet me gurë nga të miturit apo fëmijët, me qëllim të shpejtimin të shitjes së asaj shtëpie. Komuniteti i mbetur serb në qytezë ka shprehur shqetësimet (brenjosjet) e thella për sa i përket dukurisë së vazhdueshme të shitjeve të pronave. Shumë serbë të Kosovës deklarojnë se ata janë të gatshëm që ta lëshojnë vendin, për shkak se shumica e tyre janë të papunë, nuk posedojnë me liri të lëvizjes, dhe për shkak se kanë shumë pak siguri në këtë drejtim. Ata deklarojnë se ndihen disi si të lënë pas dore nga ana e bashkësisë ndërkombëtare. Ata frikësohen se nëse refuzojnë ti shesin pronat e tyre me çmim të ulët, ata do të gjuhen me gurë, apo shtëpia e tyre do të djeget, ku mëpastaj do të ballafaqohen me një situatë tejet dëshpëruese gjatë së cilës ata do të detyrohen ti shesin ato prona pa marrë parasysh llojin e ofertës.
47. Janë bërë mjaft përpjekje në këtë drejtim me qëllim të adresimit të problemit të shitjeve strategjike në komunën e Lipjanit. Për këtë qëllim, administratori komunal ka lëshuar një

seri të udhëzimeve në bazë të të cilave të gjitha shitjet ndër-etnike të pronave do të duhej që të aprovohen nga ana e administratës. Edhe pse shumica e shitjeve janë aprovuar nga ana e komunës, disa prej tyre madje edhe janë refuzuar. Duket se është duke u planifikuar që ky sistem të kopjohet edhe në rajonin e Prishtinës. Për momentin, është duke u diskutuar për aprovimin e masave ligjore në nivel të Kosovës me qëllim të ndalimit apo kufizimit të dukurisë së shitjeve ndër-etnike të pronës.

48. Do theksuar në këtë drejtim se ekzistojnë probleme përkitazi me qasjen ndaj Lipjanit, dhe gjithashtu edhe për sa i përket zhvillimit të masave ligjore në fjalë në një gjithëpërfshirës kosovar. Së pari, kufizimet në rastin e Lipjanit për sa i përket shitjeve në fjalë duket se nuk kanë baza ligjore (pushteti juridik për të penguar këto shitje është i revokuar nga ana e UNMIK-ut si pjesë e masave diskriminuese të të kaluarës së afërt). Në vazhdim, sistemi mjaft specifik i themeluar në Lipjan/Lipljan nuk parasheh të drejtën për ankesë para ndonjë tribunali të pavarur, e cila është e nevojshme për një sistem i cili merret me të drejtat pronësore të njerëzve. Gjithashtu duket të ketë krijuar vuajtje dhe mundime tek disa serbë (sidomos tek të moshuarit) të cilat kanë shprehur dëshirën që ta lëshojnë vendin edhe përkundër faktit se ata bregosen se do të mund të pengohen gjatë marrjes së parave prej shitjeve të arranzhuara na fjalë. Nëpërmjet të ndalesave të tilla ka mundësi që të zgjedhet problemi i shitjeve strategjike si dhe të gjitha problemet për të cilat folëm më lartë. Në vazhdim duhet të bëhet me dije se ndalesat e tilla do të mund ti rreken vetëm asaj çka zakonisht paraqet simptomën e cili e maskon (fsheh) problemin kryesor nga i cili rezulton kjo dukuri, e kjo është mungesa e vërtetë apo e perceptuar e sigurisë.
49. Ekzistojnë ca indikacione që bëjnë me dije se kësaj rradhe edhe komunitetet RAE janë të shënjestruara nga ofertat për shitje strategjike të pronave të tyre në masë të njëjtë si serbët. Megjithatë, dukuria e shitjeve strategjike e cila ndikon në masë të madhe tek komuniteti rom është veçanërisht e shprehur në lagjen Halit Ibishi në qytetin e Ferizajit. Një sërë raportesh për sa i përket keqtrajtimit gojorë dhe atyre fizike të bëra ndaj disa pjesëtarëve të këtyre komuniteteve ishin pranuar në këtë aspekt, keqtrajtimit këto të cilat arritën kulminacionin e tyre me dy valë të shitjes së pronave të romëve të kësaj zone, në Shtator dhe Dhjetor të vitit 2000. Blerja e pronave të romëve duket se po ndodh në mënyrë sistematike, rrugë pas rruge. OSBE-ja ka pranuar një numër mjaft të madh të ankesave të bëra nga romët përkitazi me këtë çështje. Shumë ankues bënë me dije se e njëjta mostër e kësaj dukurie është duke ndodhur edhe në rastin e tyre, në bazë të së cilës ata pohojnë se romët e mbetur së pari keqtrajtohen nga shqiptarët, për shkak se nuk dëshirojnë që ti shesin pronat e tyre, keqtrajtimit këto të cilat hapin rrugën për blerjen e mundshme të tyre nga ana e shqiptarëve. Si me rastet e tjera gjithashtu edhe këtu dëshmohet së është e pamundshme që të vërtetohen çmimet me të cilat janë bërë këto shitje për shkak se viktimat nuk shprehin dëshirë për të dëshmuar. Si e tillë është shumë vështirë që të përfundohet se ekziston një plan i organizuar për blerjen e këtyre pronave me qëllim të pastrimit të terrenit nga njëri grup etnik. Edhe pse shumica më e madhe e blerësve të pronave romë janë shqiptarë, kishte aty këtu edhe blerës Ashkalinjë dhe rom gjë që dobëson argumentin që bën me dije se një grup me qëllim është duke u përpjekur që ta largojë nga aty grupin tjetër. Okupimi i paligjshëm i pronave të romëve dhe Ashkalinjëve në të njëjtën zonë nga ana e të zhvendosurve shqiptarë që vijnë nga rajonet e tjera të Kosovës dhe gjithashtu edhe nga rajoni i Luginës së Preshevës që gjendet në Serbinë Jugore, paraqet një faktor të komplikuar shtesë me të cilën ballafaqohen komunitetet minoritare.
50. Realiteti i cili është duke mbretëruar në terren shpeshherë është mjaft i vështirë që të vlerësohet në bazë të një mori faktorëve të ndërlikuar në mes veti të cilët kontribuojnë në shitjet e vazhdueshme të pronave të minoritarëve dhe shkuarjet e tyre nga Kosova. Kamenica është një vend i cili përshkohet me një numër të shitjeve ndër-etnike të pronave, të cilat ndodhën gjatë kësaj periudhe. Në shumicën e rasteve blerësit ishin shqiptarë, përderisa shitësit ishin serbë apo romë. Shitje të tilla ndër-etnike ndodhën edhe nëpër fshatra të përzier, përderisa anëtarët e bashkësisë ndërkombëtare i deklaruan OSBE-së se e gjithë kjo erdhi si rrjedhojë e frikësimeve të shtuara gojore që vinin nga rradhët e blerësve. Informatat e tilla kanë qenë mjaft vështirë për tu vërtetuar, për arsye

se viktimat ishin të pazellshme për të bërë ankesa të drejtëpërdrejta për shkak të frikës për një frikësim të mundshëm të përmasave më të mëdha. Në vazhdim për shkak se informatat e kufizuara që shpeshherë vijnë nga burime të dorës së dytë, dhe për shkak se shitësit e kanë lëshuar më parë Kosovën duke shkuar në Serbi që do të thotë se mu për këtë ato kanë qenë në pamundësi për të dhënë komente në lidhje me këtë. Shitjet e pronave në Kamenice/Kamenica kanë tendencë që të karakterizohen me një mostër tani mëse e njohur për serbët e mbetur dhe ata të kthyer nga vendet ku jetonin si të zhvendosur përkohësisht, me qëllim të finalizimit të shitjes së shtëpive të tyre të cilat ata u detyruan që ti lëshojnë mëparë për arsye të kushteve të paqëndrueshme të sigurisë. Kjo mostër e shitjeve është përjetuar edhe nga ana e komuniteteve serbe që jetojnë në pjesët e tjera të Kosovës sidomos në Kosovën Lindore. Ajo i shmanget dhënies së përgjegjeve ndaj çështjeve kyçe se a duhen shitjet e tilla të konsiderohen si strategjike apo të themi se ato janë thjeshtë rezultat i situatës së përgjithshme të sigurisë në të cilën serbët e Kosovës dhe pakicat e tjera, të frikuar për të qëndruar në Kosovë për shkak të kërcënimit të drejtuar kah ata, dëshirojnë që së paku ti shesin pronat e tyre dhe të shpëtojnë diçka nga një situatë përndryshe mjaft dëshpëruese në të cilën gjenden ata.

### **Të drejtat pronësore**

51. Problemi i mungesës së sistemit i cili do ti mbrojë të drejtat pronësore, së bashku me problemet përcjellëse (përshkuese) të okupimeve të paligjshme dhe rindërtimit, janë paraqitur në të dyja vlerësimet paraprake dhe raportet publike të OSBE-së mbi çështjet pronësore në Kosovë në Shtator të vitit 2000. Ky problem ka një rezonim të veçantë për minoritetet, dhe pa gjetjen e zgjidhjes adekuate në këtë aspekt kthimi i minoriteteve do të vazhdojë të mbetet i bllokuar në shumë lokalitete. Një çështje mjaft cruciale këtu përqëndrohet në shkallën në të cilën, dy organe të cilat janë të autorizuar që të merren me aspektet e të drejtave pronësore, janë duke funksionuar për momentin, dhe se sa janë ato të qasshme për pakicat në fjalë. Organet relavante këtu janë Drejtorati për Çështje Banesore dhe Pronësore si dhe organet komunale.

### **Drejtorati për Çështje Banesore dhe Pronësore (HPD)**

52. Drejtorati për Çështje Banesore dhe Pronësore (HPD) dhe Komisioni për parashtrimin e ankesave banesore dhe pronësore janë themeluar me Rregulloren 1999/23 të 15 Nëntorit 1999 duke iu dhënë atyre mandatin ekskluziv mbi kontestet e ndryshme pronësoro-juridike. Kompleksitetet dhe kontraverzat ligjore të cilat i përshkojnë çështjet pronësore ka rezultuar që UNMIK-u të biejë përfundimin se çështjet e tilla do të mund të adresohen më së miri nga një organ kvazi-gjyqësor e cila qëndron jashtë sistemit normal gjyqësor. Kufizimet burimore dhe mungesa e rregullave të qarta të procedurës pengojnë përpjekjet fillestare të ndërmarra nga ana e HPD me qëllim që të nis me funksionimin e saj. Korniza juridike ishte përfunduar me prezentimin e Rregullores 2000/60 të 31 Tetorit 2000 me të cilën ishin përcaktuar rregullat e procedurës dhe dëshmimeve, duke hasur në vështirësi të cilat vazhdojnë të ndikojnë negativisht në aftësinë e HPD-së për ta kryer punën e saj. Paaftësia e vazhdueshme e HPD-së për të arritur objektivat e saja dhe të arrit kapacitetin e saj të plotë paraqet një burim të shqetësimit (brenqosjes) së shtuar.
53. Çështjet pronësore janë me **rëndësi të veçantë për popullatën pakicë**. Gjykimi i drejtë i kontesteve pronësore paraqet një faktor crucial për tërë procesin e kthimit dhe kërkimit të zgjidhjeve afatgjate. Personat e zhvendosur në brendi dhe jashtë kufijve të Kosovës edhe ashtu të merakosur presin rastin e parë për të paraqitur kërkesat pronësore. Me lirinë e kufizuar të lëvizjes e cila mbretëron sot për shumicën e serbëve të Kosovës, të cilët për arsye të sigurisë janë në pamundësi që të shkojnë tek zyret e HPD-së, ka qenë mëse e nevojshme që të inkorporohet elementi mobil i shërbimeve të ofruara nga HPD-ja. Një rritje e numri të këtyre shërbimeve është mëse e nevojshme (domosdoshme). Komunitetet e tjera minoritare gjithashtu ballafaqohen me probleme të lirisë së lëvizjes (edhe pse në shkallë më të ulët), përderisa nevojat e tyre duhet të konsiderohen si një rrjet i zgjeruar mobil i aftë që t'ju përgjegjet kërkesave të ndryshme në këtë aspekt.

Kapaciteti i tanishëm nuk është i mjaftueshëm, dhe si rezultat i kësaj kemi krijimin e listave të gjata në këtë drejtim.

54. Në të njëjtën vijë, duhet përbushur edhe nevojat e veçanta të atyre që momentalisht janë të zhvendosur jashtë Kosovës. HPD-ja mban përgjegjësi ndaj lehtësimit të qasjes në këto procedura edhe nëpërmjet të prezencës së saj jashtë Kosovës. Në mungesë të kësaj e vetmja mundësi e hapur për personat e zhvendosur është që të udhëtohet për në Kosovë dhe të vizitohen njëri prej zyreve ekzistuese të saj me qëllim të parashtrimit të kërkesës (ankesës). Kjo është tejet e vështirë, mos të themi e pamundur, për tu arritur në disa raste. Si një hap i parë që duhet ndërmarrë për zgjedhjen e këtij problemi është edhe shkuarja e ekipeve mobile të HPD-së për në Serbi dhe Mal të Zi e cila gjë do të lehtësonte që shumë persona të zhvendosur nëpër ato vende të kenë mundësi të qasjes shërbimeve të kësaj zyreje. Megjithatë mund të themi se është esenciale që zyrat e HPD-së të hapen edhe jashtë Kosovës gjatë këtij viti. Mekanizma të përshtatshëm duhet gjithashtu të formohen në këtë drejtim me qëllim që të përbushin nevojat e atyre personave të zhvendosur edhe më larg regjionit, ku edhe me hapjen e zyreve për qasje ndaj tyre në RFJ ata nuk do të kenë mundësi që t'ju qasen shërbimeve të cilat këto zyre i ofrojnë.

### **Autoritetet komunale**

55. **Roli të cilin e luajnë komunat për sa i përket çështjeve pronësore do të fitojë në seriozitet (rëndësi) gjatë vitit 2001.** Përderisa minoritetet janë të brengosura, një fushë e cila zgjon interesim të veçantë në këtë aspekt ka të bëjë me rolin të cilin autoritetet komunale mund ta kenë në vlerësimin e pronave të braktitura dhe ndarjen e tyre për okupim të përkohshëm për qëllime humanitare<sup>10</sup>. Kjo punë mund të konsiderohet si mjaft kryesore, si në vlerësimin e madhësisë së pronës së braktitur ashtu edhe sigurimin se çdo ndarje e pronave ruan mundësinë për një kthim të mundshëm të pronarit, përderisa të stabilizohet gjendja në të cilën jeton popullata e mbetur pakicë. Përpos faktit se një numër i autoriteteve komunale janë të trajnuara nga ana e HPD-së me qëllim që të udhëzojnë dhe lehtësojnë aktivitetet e tyre në kuadër të këtij pushteti të deleguar, indikacionet nga terreni terreni tregojnë se disa komuna kanë nisur punën e tyre për sa i përket ndërmarrjes së aktiviteteve të tyre në këtë drejtim.
56. Pas zgjedhjeve komunale të 28 Tetorit 2000 ishte paraparë që secila komunë të shqyrtojë autoritetin e saj banesor si dhe gjithashtu të shqyrtojë edhe anëtarësinë e saj dhe funksionet e tyre. Sidoqoftë regjistrimet e mbajtura nëpër secilën komunë kanë zbuluar faktin se shumë pak njerëz kanë vepruar në këtë drejtim, duke vazhduar që edhe deri më sot të funksionojnë në kuadër të strukturave që vepronin para zgjedhjeve. Në disa raste, organet e tilla janë thjeshtë pasardhësit e organeve të vetëemëruara të cilat ekzistonin më parë të cilat ishin riabsorbuar në strukturat komunale si ato të organizuara në fillim të vitit 2000. Paanshmëria e disa prej organeve në fjalë mund të vihet në pyetje në këtë rast. Me njohjen e rolit të rëndësishëm të cilën e luajtën disa prej strukturave lokale në nivel komunal do të jetë tejet e rekomandueshme për secilën komunë të marr hapa drejt reformimit të anëtarësisë së komisionit të saj vetanak për ankesa duke lëvizur drejt strukturave të përfaqësuara më mirë duke përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen e anëtarëve minoritar në këtë aspekt.

<sup>10</sup> Rregullorja 1999/23 autorizon HPD të mbajë një regjistrim për pronat e braktitura në Kosovë dhe mbikëqyr shfrytëzimin e kësaj prone për kohë të përkohshme dhe në baza humanitare. Rregullorja 2000/60 në të kundërtën autorizon HPD-në që të delegojë disa prej funksioneve të saja komunave të ndryshme në Kosovë, të cilat mëpastaj i nënshtrohen parapregaditjeve (organizimit paraprak) për sa i përket mbikëqyrjes në fjalë në mënyrën më të përshtatshme të mundshme. Përderisa regjistrimi i pronave të braktitura duhet të mbahet në të ardhmen mbetet të shihet se cili është përpjestimi i shtëpive që janë në pronësi të minoriteteve. Sidoqoftë është mjaft e arsyeshme që të përfundohet se kjo do të jetë një çështje më rëndësi të veçantë për komunitetet minoritare duke pasur parasysh shkallën e ikjes së tyre nga Kosova.



## **Rindërtimi**

57. Vlerësimi paraprak potencoi një sërë problemesh që kanë të bëjnë me qasjen e minoriteteve ndaj programit zyrtar për ndihmë në rindërtim. Në Mars 2000, Departamenti për Rindërtim përpiloi udhëzimet e tija për rindërtimin e shtëpive, duke siguruar udhëzime të rëndomta për identifikimin e përfituesve nga kjo ndihmë, për standardet e rindërtimit dhe renovimit për sa i përket pronave të dëmtuara dhe shkatërruara si dhe për procedurat implementuese dhe për ko-ordinimin e përgjithshëm të aktiviteteve dhe akterëve në këtë proces. Në pajtim me udhëzimet në fjalë, ndihma për rindërtim gjatë vitit 2000 iu ishte ndarë njerëzve nëpërmjet të komisioneve banesore komunale të cilët morrën përgjegjësinë për aprovimin e identifikimit të fshatrave dhe familjeve përfituese nga kjo ndihmë. Duke e ditur se pjesëmarrja e minoriteteve në punën e komisioneve të tilla ishte minimale, ky fakt shpeshherë rezultonte me pohime për diskriminime të bëra në këtë aspekt dhe shpërndarjes së padrejtë të burimeve në këtë kontekst. Pjesëtarët e komuniteteve minoritare i ishin ankuar OSBE-së se ata nuk dinin fare për këto udhëzime (direktiva), për të drejtën e tyre për të aplikuar për një ndihmë të tillë, ose kur aplikacioni i tyre refuzohet, kanë të drejtë të dinë për arsyen e këtij refuzimi. Udhëzimet (direktivat) shprehimisht përmendin për 5-10% të fondeve të premtuara do të ndahen për ti përmbushur nevojat e minoritarëve, mirëpo revidimi i buxhetit të vitit të kaluar bënte me dije për shifrën prej 2% e cila është arritur në rajon. Përderisa disa komuna nuk mbanin dosje (dhëna) të qarta mbi përfituesit e ndihmës për rindërtim, u tregua gati si e pamundshme për të arritur deri tek një shifër e saktë mbi atë se sa është numri i përgjithshëm i tyre. Nga vlerësimi i përgjithshëm në lidhje me shifrën prej 2%, megjithatë është e qartë se shifra e për të cilën mëtohej nuk ishte arritur. Udhëzimet e reviduara për vitin 2001 të cilat duhet të finalizohen së shpejti, parashohin se përqindja e fondeve e cila duhet ndarë për vitin 2001 duhet të jetë 15 %, pjesërisht me qëllim që të fitohet një dëmshpërblim (kompensim) për mungesën përkatëse. Kjo megjithatë do të jetë diku rreth 15 % e qëllimit global të reduktuar në masë të madhe. Donatorët e kanë të njohur faktin për sa i përket nevojës për mbajtjen e fleksibilitetit në këtë drejtim përderisa çdo rritje e intenzitetit të kthimit do të parashtrijë kërkesa shtesë nga fondet dhe burimet të cilat i kemi në dispozicion.
58. Duke i njohur problemet të cilat kishin ndodhur gjatë vitit 2000, Departamenti për Rindërtim së bashku me donatorët kyç në këtë proces u zotuan se do të kenë një qasje më fleksibile për vitin 2001 dhe kërkuan të dijnë edhe për pikëpamjet e akterëve të informuar në këtë aspekt për sa i përket faktit se si mund të arrihen më së miri përparimet e planifikuara në këtë drejtim. Udhëzimet e reviduara kishin përfituar nga një diskutim i gjerë i mbajtur mbi atë çka ishte mësuar gjatë vitit të kaluar dhe ata tani dinë se si të bëjnë referime për sa i përket nevojës për reagim (përgjegje) adekuate ndaj nevojave specifike të minoriteteve të ndjeshme në këtë aspekt natyrisht në një vijë me politikën e përgjithshme të UNMIK-ut për sa i përket stabilizimit të gjendjes për komunitetet minoritare dhe të punohet drejt themelimit të kushteve të përshtatshme për kthim. Në vazhdim, Departamenti në fjalë u zotua se se do të bëjë një vlerësim lidhur me dëmtimin e një numri të caktuar të lokaliteteve ku jetojnë minoritetet me qëllim që të fitohet një njohuri më e mirë përkitazi me shkallën e sfidës me të cilën do të duhej të ballafaqohemi për sa i përket nevojave për rindërtim të pakicave. Pasi që të jetë finalizuar (kompletuar) mbetet të shihet se si direktivat e reviduara në fjalë do të implementohen në nivelin komunal. Se a do të kenë këto direktiva (udhëzime) një ndikim pozitiv në këtë aspekt i cili do të rezultojë në një shpërndarje më të drejtë të ndihmës për rindërtim e cila në masë të madhe do të varet nga fakti se sa të hapura dhe sa fleksibile do të jenë strukturat komunale që janë të autorizuara për ti zbatuar ato direktiva (udhëzime). Përfshirja aktive e përfaqësuesve të pakicave në strukturat komunale, si e nënvizuar mëposhtë, do të jetë një faktor tjetër esencial drejt sigurimit të një sistemi më të drejtë dhe më korrekt në këtë drejtim.
59. Është shumë e rëndësishme që të njihet fakti se nevojat për ndihmë në rindërtim të popullatës minoritare ndryshojnë nga ato të popullatës shumicë. Ndihma për ti rindërtuar shtëpitë dhe për të siguruar një strehim më afatgjatë natyrisht se paraqet një nevojë

themelore humane e cila do të duhet tu jipet të gjithëve. Sidoqoftë, hapi i cili duhet ndërmarrë në këtë drejtim dhe lloji i ndihmës e cila kërkohet mund të ndërrojë prej një komuniteti në tjetrin. Për shembull shumica absolute e ndihmës në rindërtim sigurohet në formë të dhënies së ndihmës për projekte vetanake, si për shembull, pranuesit e ndihmës ndërmarrin ndërtimin e një objekti duke i shfrytëzuar materialin e dhënë nga donatori. Kjo ka dëshmuar të jetë një mënyrë mjaft efektive për dhënien e ndihmës për të kthyerit shqiptarë të cilët kanë qenë në gjendje që ti shfrytëzojnë të gjitha burimet e tyre familjare si ato ekonomike (financiare) ashtu edhe ato në njerëz të aftë për punë me qëllim të sigurimit të një rindërtimi të shpejtë në bazë të pranimi të ndihmës origjinale. Në rastin e përfituesve (shfrytëzuesve të kësaj të drejte) puna e cila i pret ata në këtë drejtim është mëse shkurajuese. Ata kanë në dispozicion një numër të vogël të burimeve për ndihmë shtesë të cilat duhet ti thirrën, përderisa komplikimet të cilat lindin këtu për shkak të kufizimeve në lirinë e lëvizjes së këtyre personave e cila e pengon aftësinë e tyre për të bartur materialin dhe mjetet si dhe fuqinë punëtore dha mu për këtë arsye ata vazhdojnë që të punojnë me një ritëm mjaft të arsyeshëm (hap të arsyeshëm). Në rastin e të kthyerit të mundshëm në këtë drejtim kjo do të jetë veçanërisht e rëndësishme. Nëse të kthyerit minoritar nuk mund të llogarisin në një shpërndarje të shpejtë të materialit ndërtimor, atëherë është rrezik që ata të mos kenë mundësi që ti përfundojnë punët e tyre me kohë dhe si rezultat i kësaj do të duhet të kthehen në gjendjen e mëparshme si të zhvendosur. Procedurat ekzistuese për t'ju qasur këaj ndihme i nënshtrohen kushtit paraprak e cila thotë se përfituesit (shfrytëzuesit e kësaj të drejte) duhet të jenë në *in situ* (që do të thotë në vend të ngjarjes) para se të mirren në konsideratë. Duke u thirrur në faktin se pjesa më e madhe e ndihmës është në njëfarë mënyre konsideratë praktike tejet e vlefshme. Megjithatë, për ta bërë një sistem më fleksibil dhe për të qenë i gatshëm që të përgjigjemi shpejtë ndaj nevojave të të kthyerit, një sërë opcionesh janë duke u marrur parrasysh duke përfshirë këtu edhe për shembull mundësinë e dorëzimit të aplikacionit për ndihmë gjatë vizitave shko dhe shih të cilat mbahen rregullisht nga këta të kthyer. Shpresohet se modifikimet e tilla do ta bëjnë sistemin më pak të harxhuar apo burokratik dhe përfundimisht më shumë të përgjegjshëm ndaj nevojave të shfrytëzuesve në fjalë.

## Qasja ndaj strukturave politike

60. Vlerësimi i fundit për minoritetet, i publikuar pak para zgjedhjeve komunale të 28 Tetorit, kishte vërejtur se **çështja e emërimit të pjesëtarëve të minoriteteve nëpër asamblë të komunale do të mund të jetë kryciale** me qëllim të sigurimit të një pjesëmarrjeje të minoriteteve nëpër strukturat e reja. Pushtetin për ti caktuar këto emërimet e ka PSSP-ja në bazë të Seksionit 47 të Rregullores 2000/45.<sup>11</sup> Për shkak se nuk kemi në dispozicion shifra zyrtare për sa i përket numrit të minoritarëve të cilët jetojnë nëpër secilin lokalitet, përfaqësimi duke iu përmbajtur përpjestimit të numrit të popullsisë minoritare në secilën komunë, thuhet se është i pamundur. Për këtë arsye, është shumë vështirë që ti qasemi me një saktësi absolute se a është një komunitet i nën përfaqësuar apo jo, dhe nëse po atëherë këtu ndihet nevoja për përfaqësues të ko-optuar në këtë drejtim. Sido që ta marrim është i kontestueshëm fakti se përmbajtja strikte ndaj konceptit të proporcionalitetit ndonjëherë mund të mos jetë mjeti më i mirë për të arritur një përfaqësim të duhur dhe efektiv të minoritarëve në këtë aspekt.
61. Në bazë të Rregullores 2000/45 mekanizmat përkatës special në formë të komiteteve ishin përcaktuar (paraparë) për secilën komunë me qëllim që të sigurohet se interesat e minoriteteve të monitorohen dhe adresohen si është më së miri. Për këtë arsye, një hap krycial për minoritetet sidomos në implementimin e komunave të sapoformuara ka qenë krijimi (dhe anëtarësia e) i Komiteteve të Minoriteteve dhe Komiteteve për Ndërmjetësim, (të cilat Asamblë të ishin të obliguara që ti themelojnë në bazë të Seksionit 21 të Rregullores në fjalë), si dhe hapja dhe pajisja me personel adekuat i Zyrave të Komuniteteve nëpër komunat ku minoritetet formojnë një pjesë substanciale të popullatës. Nuk ekziston asnjë pjesë në Rregulloren e sipërpërmendur e cila e pengon

<sup>11</sup> 47.3 Përfaqësuesi Specila i Sekretarit të Përgjithshëm mund të ko-optojë edhe anëtarë të tjerë shtesë nëpër Asamblë të Komunale nëse konsideron se duhet bërë një gjë të tillë me qëllim të sigurimit të përfaqësimit të të gjitha komuniteteve në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit.

kyçjen e përfaqësuesve të pakicave në strukturat e tjera komunale. Me të vërtetë, një vlerësim faktik mbi kyçjen e pjesëtarëve të minoriteteve nëpër organet e tilla siç janë Komitetet për Politikë dhe Financa dhe Bordi i Drejtorëve, mund të themi se siguron indikacione të qëndrueshme për tendencën, apo mungesën, nga ku duhet të kyçen minoritetet edhe aty ku nuk ndjehet ndonjë obligim për ta bërë këtë. Kyçja e tyre “në rrjedhat” e Asembleve Komunale i bën që minoritetet jo vetëm të marrin pjesë në strukturat speciale por edhe në zemrën e vendim marrjes. Se çfarë gjëje kuptimplote na bie pjesëmarrja apo influenza e një kyçjeje të tillë të minoriteteve mbetet të shihet në të ardhmen.

62. Duhet të ceket se **procesi i kooptimit të pjesëtarëve të minoriteteve nëpër Asembletë Komunale nuk ka përfunduar ende**. Ulëset nëpër këto Asemble mbeten të pambushura nëpër disa prej komunave, apo, përderisa pjesëtarët e minoriteteve të mos ko-optohen nëpër këto poste, ata nuk janë duke marrur pjesë nëpër këto struktura për momentin. Shtërpce është një shembull i rastit të fundit ku Asembleja Komunale ishte shpërndarë pas ngjarjeve të 13-16 Shkurtit.
63. Kemi edhe pjesëtarë të minoriteteve të cilët janë zgjedhur nëpër disa komuna. Edhe pse në numër të vogël, **një numër i partive minoritare arriti që të fitojë një numër të ulësive nëpër këto asamble pas zgjedhjeve**. Në Dragash/Drage, Iniciativa Qytetare Gorane (IQG) fitoi tre vende në Asemblenë e asaj komune, përderisa SDA-ja boshnjake dy. Partia e Ashkalinjëve (PDASHK) fitoi një vend në Fushë Kosovë. SDA-ja gjithashtu fitoi një vend në Istog, dhe një tjetër në Pejë. Dhe së fundi, në Prizren, Partia Boshnjake e Veprimit Demokratik (BSDAK) fitoi dy vende, përderisa një parti tjetër muslimane, DRSM-ja, fitoi një vend. Në vazhdim, në të gjitha këto komuna me përjashtim të Dragashit, PSSP-ja gjithashtu kishte ushtruar pushtetin e tij të ko-optimit.
64. **Emërimet nga ana e PSSP-së** për Asembletë Komunale janë bërë pas konsultimeve të zgjeruara me akterë vendor dhe ndërkombëtar dhe për të gjitha përpos për 6 komuna, përfaqësuesit e minoriteteve ishin emëruar nëpër postet e tyre.<sup>12</sup> Në përgjithësi që nga 1 Marsi, një shumë e përgjithshme prej 869 përfaqësuesve të zgjedhur dhe 123 të emëruar apo nga vendet e ndara në komunat ku rezultatet e zgjedhjeve ishin konfirmuar, ku 91 prej tyre janë serb, 14 Sllavo-Musliman, 10 Ashkalinjë, 9 Romë, 5 Turq, 4 Egjiptas dhe një Kroat. Një sistem i ndryshëm i emërimeve ishte shfrytëzuar në tre komunat veriore të Leposaviqit, Zubin Potokit dhe Zveçanit ku zgjedhjet ishin mbajtur mirëpo rezultatet e saja nuk ishin konfirmuar për shkak se shumica e popullatës serbe as nuk ishin regjistruar e as nuk kishin votuar. Prosesi i ko-optimit nëpër këto komuna përfshiu edhe shqiptarët e Kosovës të cilët përbëjnë një pakicë numerike në këtë zonë.<sup>13</sup>
65. Një debat për sa i përket kriterit të shfrytëzuar mbi emërimin e përfaqësuesve dhe skepticizmit i cili mbretëron tek disa komunitete minoritare në lidhje me faktin se si është ushtruar pushteti i kooptimit gjer më tani, është duke u mbajtur në këtë drejtim, si dhe mbi perceptimin nga ana e disa prej komuniteteve minoritare në lidhje me atë se si është ushtruar pushteti i kooptimit gjer më tani. Komuniteti i vogël turk i cili jeton në Vucitri/Vucitrn, për shembull, i cili nuk ka përfituar shumë në Dhjetor të vitit 2000 parashtroi një ankesë PSSP-së duke kërkuar nga ai sqarime në lidhje me atë se pse gjer më tani nuk është bërë ndonjë kooptim në këtë komunë. Në përgjithësi procedura në fjalë ashtu si e aplikuar nuk ka rezultuar me ndonjë përfaqësues të emëruar nga secili grup minoritar, përderisa grupet e tjera të cilat dukshëm janë më të mëdha në numër u ishte dhënë rëndësi më e madhe. Kjo do të mund të ketë ndikuar negativisht në disa prej komuniteteve në fjalë, në veçanti ato që janë të shpërndara, sidomos komunitetet e vogla si ajo rome, mirëpo gjithashtu edhe në komunitetet Ashkali dhe Egjiptase. Kemi

<sup>12</sup> Asnjë emërim i këtij lloji nuk është bërë në komunat e banuara me shumicë absolute shqiptare siç janë Decani/Decan, Glogovci/Glogovc, Kacaniku/Kacanik, Malisheva/Malisevo, and Suhareke/Suva Reka, apo edhe në Dragash, ku pesë përfaqësues të minoriteteve u ishte dhënë vota e popullit për Asemblenë Komunale (tre prej partisë gorane, GIG, dhe dy nga partia boshnjake SDA).

<sup>13</sup> 15 Serbë të Kosovës dhe 2 shqiptarë ishin emëruar në Zubin Potok; 14 Serbë të Kosovës; 1 Sllavo Musliman dhe 2 Shqiptarë të Kosovës janë apo do të emërohen në Leposavic/Leposaviq; dhe 13 Serbë të Kosovës janë emëruar në Zveçan (komunë kjo e cila është vënë në dyshim nga ana e Shqiptarëve të Kosovës), përderisa emërimet e dy Shqiptarëve dhe një Serbi tjetër mbetet për tu zgjidhur.

kundërshtimisht dy qasje të ndryshme në lidhje me faktin se si duhet përfaqësuar minoritetet nëpër këto assembletë komunale. Së pari, duke pasur parrasysh ndjeshmërinë e grupeve minoritare dhe frikën që i kaplon këto komunitete se pa përfaqësim të tyrin vetanak, nevojat dhe perspektivat e komuniteteve të tyre nuk do të mund të ndëgjohen fare, dhe mu për këtë arsye mund të konsiderohet si i pazëvendësueshëm fakti se secili komunitet në secilën komunë duhet të jetë i përfaqësuar në Asemblenë e asaj komune. Përndryshe, një gjë e tillë mund të kontestohet edhe me faktin se insistimi për përfaqësim të secilit komunitet mbjell dhe vë themelet e një perceptimi tjetër se vetëm pjesëtarët e një komuniteti mund ta përfaqësojnë atë komunitet si është më së miri, dhe të punojnë për interesat e atyre të cilët ata i përfaqësojnë. Shkalla deri në të cilën përfaqësuesit e zgjedhur dhe ata të kooptuar demonstronjë vullnetin e mirë për të kapërcyer kufijtë e interesave të grupit të tyre etnik me qëllim të një përfaqësimi sa më gjithëpërfshirës mbetet të shihet në të ardhmen. Se, a i kufizojnë ata në të vërtetë veprimet e tyre për të mirën e komuniteteve të tyre, apo konsultohen me të tjerët për të punuar për të mirën e të gjithë banorëve të komunës së tyre, e gjithë kjo duket të jetë një testim për demokracinë. Shihet se pjesëtarët e disa prej komuniteteve minoritare nuk e përmbajnë vetën për të dhënë votën e tyre vetëm në baza etnike mirëpo prapëprapë është e pamundshme të thuhet se deri në çfarë mase një gjë e tillë ka ndodhur dhe deri në çfarë shkalle parashikimet e tyre do të përmbushen (plotësohen) prej partive kryesore të cilat përfituan nga votat e këtyre njerëzve.

66. Insistimi në Rregulloren 2000/45, mbi të drejtën që secila Komunë të ketë mundësi që vetë ti emërojë **Komitetet e Komuniteteve dhe Komitetin për Ndërmjetësim sugjeron se ende** ekzistojnë shqetësimet për sa i përket faktit se pa organe speciale në këtë drejtim, grupet minoritare do të mund të çkyqen nga loja që duhet të luhet në kuadër të Assembleve Komunale në fjalë. Përbërja e këtyre dy komiteteve speciale në fjalë kërkon një përfaqësim të duhur të minoriteteve. Komitetet e komuniteteve duhen, që në bazë të Seksionit 23.3, të përfshijnë në veti edhe anëtarë të Asemblesë Komunale (qofshin ata të zgjedhur apo të kooptuar), ku gjithashtu duhen të përfshijnë edhe përfaqësues nga secili komunitet minoritar-së paku nga një përfaqësues prej secilit grup etnik minoritar. Komitetet e Komuniteteve posedojnë me një pushtet deri diku të kufizuar përkitazi me orvatjet për të siguruar që nënpunëzit publik të aplikojnë një praktikë jodiskriminuese, të respektojnë të drejtat e njeriut, mundësi të drejta dhe të barabarta për punësim, dhe ashtu që shërbimi civil në kuadër të secilës komunë të reflektojë një proporcion të drejtë përkitazi me pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve në të. Këto në rradhë të parë paraqesin funksione mbikëqyrëse dhe promovuese-gjë që paraqet më shumë një çështje të influencës sesa të pushtetit (fuqisë)-dhe ku Komiteti përfundon se një veprim i cili është ndërmarrë mëparë apo duhet të ndërmirret në të ardhmen do të mund të bëjë shkelje të të drejtave të njeriut apo të mundësive të barabarta për punësim, atëherë ajo ia përcjell rastin Komitetit për Ndërmjetësim. Duhet të ceket se një përgjegjësi e tillë mbikëqyrëse për sa i përket mundësive të barabarta për punësim nuk është e kufizuar vetëm në shqetësimet përkitazi me minoritetet; barabartësia e gjasave për punësim duhet të mbërthejë në veti edhe konsideratën që duhet dhënë për sa i përket diskriminimit të bërë në çfarëdo baze, duke përfshirë këtu edhe atë të bërë në baza të gjinisë dhe mendimit politik.
67. Asnjë komunë deri më tani nuk ka emëruar **Komitetet e Komuniteteve** në fjalë. Në periudhën kohore deri më 7 Mars 2001, 10 prej komunave të cilat janë dashur që ti emërojnë këto komitete, ato nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Kjo veçanërisht paraqet një gjë fatkeqe duke marrur parrasysh faktin se njëra prej fushave kryesore ndaj të cilave Komiteti në fjalë ka mbikëqyrje - është sigurimi i një përfaqësim të drejtë dhe mundësive të barabarta gjatë zgjedhjes së nënpunësve civil komunal - gjë e cila është duke ndodhur nëpër disa komuna (shih seksionin mbi Punësimin). Përsëri, mbetet të shihet se a do të kenë të ashtuquajturat Komitete të Komuniteteve pasi që të formohen natyrisht, influencë në politikën e komunave dhe implementimin e tyre, apo do të përjashtohen nga kjo lojë (nuk do të përfillen fare). Kjo gjë varet më shumë nga funksionimi i Komitetetve për Ndërmjetësim.

68. **Komitetet për Ndërmjetësim** përbëhen nga një numër i barabartë i anëtarëve të Asemblesë (mirëpo një gjë e tillë nuk vlen për Komitetet e Komuniteteve), dhe përfaqësuesit në proporcion të drejtë të komuniteteve minoritare të secilës komunë përkatëse. Kjo përbërje e Komiteteve në fjalë siguron një brez të gjerë të anëtarëve të Asemblesë Komunale që duhet të përfshihen në Komitetet e Komuniteteve dhe Komitetet për Ndërmjetësim. Është e diç e çuditshme fakti, se shumica e komunave kanë emëruar (caktuar) më shumë Komitetet për Ndërmjetësim sesa ato të Komuniteteve – përderisa që nga 7 Marsi edhe 6 komunat e tjera duhet ti emërojnë Komitetet për Ndërmjetësim - Malisheva/Malisevo, Mitrovica/Mitrovica, Obiliqi/Obilic, Peja/Pec, Skenderaji/Srbica, Strpce/Shtërpce, dhe Vitia/Vitina.
69. Komiteti për Ndërmjetësim ka pushtet për të hetuar rastet të cilat i janë referuar nga Komiteti i Komuniteteve, përkitazi me pohimet përkatëse sa i përket shkeljeve apo rrezikimit të të drejtave të komunitetit në tërësi apo të një pjesëtari të atij komuniteti, dhe siç tregon edhe vetë emri i këtyre Komuniteteve, ato shërbejnë si ndërmjetësuese gjatë zgjedhjes së problemeve. Brenda 28 ditëve pasi që është parashtruar ankesa, Komiteti për Ndërmjetësim duhet të dorëzojë një raport me rekomandime Asemblesë Komunale, e cila Asemble pastaj merr vendim në lidhje me atë se çfarë veprimi duhet ndërmarrur në këtë drejtim. Ai vendim mund të refuzohet në mënyrë efektive nga ana e Komitetit të Komuniteteve, që mëpastaj ti referohet Autoritetit Qëndror për shqyrtim të mëtutjeshëm.
70. Përsëri, ekziston një praktikë e vogël për momentin në të cilën do ta bazonim vlerësimin përkitazi me funksionimin e Komiteteve për Ndërmjetësim në vendet ku këto Komitete janë formuar. Duke marrur parrasysh faktin se marrëdhënia ndërmjet të përbërjes dhe pushtetit të Asemblesë Komunale dhe komiteteve speciale për tu drejtuar kah një strukturë konstruktive dhe e përbashkët përforcuese, dihet se ekziston një potencial i cili nëse shfrytëzohet në mënyrë efektive do të bëjë që i tërë sistemi të funksionojë mirë për sa i përket mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe interesave të të gjitha komuniteteve. Gjatë muajve të ardhshëm përsëri do të kërkohet një monitorim i bërë mjaft me kujdes për të vuar në jetë një vlerësim të tillë në të ardhmen, dhe gjithashtu me qëllim të përcaktimit se a munden këto komitete speciale të angazhohen në tërësi (plotësisht) në vendim-marrje nëpër komunat përkatëse, apo ndoshta ato janë të përjashtuara nga loja (të çkyqura nga ky proces).
71. Struktura përfundimtare specifike e cila fokusohet në komunitetet minoritare është **Zyra për Komunitete**. Zyret e tilla janë një dukuri mjaft e kërkuar sidomos nëpër ato komuna ku komunitetet minoritare përbëjnë një pjesë substanciale të popullatës. Udhëzime të pakta ekzistojnë në këtë drejtim për sa i përket se çka do të thotë kjo "pjesë substanciale" në të vërtetë dhe siç kemi cekur mëparë mungesa e shifrave të sakta dhe të besueshme në këtë aspekt e bëjnë një përcaktim të tillë edhe më të vështirë. Zyra në fjalë mund të themi se mban përgjegjësi përkitazi me përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve dhe sigurimit të qasjes së barabartë ndaj shërbimeve përkatëse të cilat ofrohen në nivel komunal; përderisa ky i fundit është me rëndësi kryesore në mënyrë që të sigurohet që Asembleja Komunale të ushtrojë autoritetin e saj mbi çështjet siç janë kujdesi shëndetësor dhe arsimit, dhe atë në një mënyrë jodiskriminuese. Sidoqoftë edhe njëherë duhet të ceket se pushteti i Zyres në fjalë është i kufizuar; ajo i raporton Komitetit të Komuniteteve; përderisa shefi i Zyres së Komuniteteve është i emëruar ex-officio në Bordin Komunal të Drejtorëve. Këta zyrtarë nuk duhet të habiten me Oficerët e Komunitetit Vendor të cilët janë zyrtarë ndërkombëtarë të punësuar nga ana e UNMIK-ut si pjesë e Shtyllës II, në Departamentin e Administratës Lokale. Pjesëtarët e stafit ndërkombëtar të cilët punojnë si Oficerë për Komunitetet Vendore, të cilët për momentin numërojnë deri në 28 sosh dhe janë të përfshirë mjaft në themelimin e Zyreve të Komuniteteve në nivel të komunave. Ato njëkohësisht, sipas nevojës, sigurojnë edhe inkurajim të mjaftueshëm dhe përkrahje praktike në këtë drejtim.

72. Deri më 7 Mars, 7 komuna kanë hapur të ashtuquajturat Zyre të Komuniteteve, shpeshherë edhe me pjesëmarrjen apo udhëheqjen e Oficerit të UNMIK-ut për Komunitetet Vendore. Zyret janë hapur edhe në Ferizaj/Urosevac, Gjilan/Gnjilane, Kamenice/Kamenica, Mitrovice/Mitrovica (ku asnjëra prej këtyre komiteteve speciale nuk janë kompletuar deri më tani), Novo Berde/Novo Brdo, Rahovac/Orahovac and Viti/Vitina. Siç pritet, duke u bazuar në përbërjen e tyre etnike, komunat juglindore posedojnë me një numër të mjaftueshëm të Zyreve të Komuniteteve. Rajoni tejte i përzier etnikisht i Prizrenit, për shembull ka vetëm një zyre të tillë dhe atë në Rahovec/Orahovac.
73. Një fushë kyçe në të cilën minoritetet kanë siguruar nivel të ulët të përfaqësimit është ajo në **Komitetet për Politikë dhe Financa** të cilat paraqesin një veçori mjaft të kërkuar nëpër secilën Asemble Komunale. Pushteti i këtij organi ngërthen në vete propozimin e buxhetit komunal dhe hulumtimin e direktivave të ardhshme strategjike të secilës Komunë. Përbërja e komitetit përfshin Kryetarin e Komunës (si kryesues). Seksioni 22 është në njëfarë mënyre i pakuptimtë për sa i përket mënyrës së pjesëmarrjes së Kryesuesve të Komiteteve të Komuniteteve dhe Komiteteve për Ndërmjetësim, duke thënë vetëm se ata do të kenë të drejtë ti ndjekin mbledhjet e Asemblesë Komunale.
74. Ngjashëm dhe gjithashtu nuk paraqet ndonjë befasi, shumica e ulëseve në **Bordin e fuqishëm të Drejtorëve** të Asemblesë Komunale, e cila zbaton në praktikë të gjitha vendimet e marrura në këtë drejtim, i takojnë shqiptarëve të Kosovës. Procesi i pajtimit për sa i përket përbërjes së Bordit kërkon që Kryetari i secilës Asemble Komunale të prezentojë nga një propozim i cili do të aprovohet nga Administratori Komunal i KB-ve para se të prezantohet për aprovim, si një pako e propozimeve, Asemblesë Komunale. Sidoqoftë, minoritetet janë të përfaqësuara vetëm në Dragash/Dragas (një përfaqësues i GIG-ut), në Gjilan/Gnjilane (një Ashkali nga partia PDASHK dhe gjithashtu një serb i Kosovës), Kamenice/Kamenica (dy ulëse janë të rezervuara për serbë të Kosovës, përderisa për momentin njëri prej tyre është i paplotësuar), Mitrovice/Mitrovica (tre serbë të Kosovës), Podujeve/Podujevo (një Ashkali nga PDASHK-ja), dhe Prizreni (një nga PDASHK-ja). Duket se serbët e Kosovës dhe Ashkalinjtë kanë kaluar më së miri për sa i përket fitimit të vendeve në Bordin e Drejtorëve krahasuar me grupet e tjera minoritare dhe përkundër faktit se 15 komuna kanë ende për të bërë në finalizimin e përbërjes së Bordeve të tyre, përbërja e përgjithshme etnike e Asembleve të këtyre komunave bën me dije se serbët nuk do të paraqiten në përbërjen e këtyre Bordeve në ndonjë numër të dukshëm. Për këtë arsye, edhe pse është mjaft inkurajues fakti për sa i përket prezencës së disa prej minoriteteve në përbërjen e Bordit, gjithashtu duket se grupet përkatëse minoritare janë lënë jashtë përbërjes së këtyre organeve.
75. Në përgjithësi, sistemi i kooptimit të minoriteteve ka ndikuar në përbërjen e Asembleve Komunale. Në shumë raste, ky ndikim ka qenë mjaft i rëndësishëm, edhe pse disa komuna me një numër të vogël të pjesëtarëve të komuniteteve minoritare, sidomos ato rome dhe egjiptase, nuk janë të përfaqësuara në atë mënyrë që secili minoritet të ketë përfaqësuesin e vet. Përbërja e komiteteve speciale nuk bën me dije për sa i përket se deri në çfarë mase minoritetet janë të integruara në strukturat kryesore të Asembleve, për shkak se përbërja e tyre është e caktuar dhe definuar në mënyrë mjaft të qartë; 50% e përfaqësimit të minoriteteve në Komitetet për Ndërmjetësim, për shembull është i natyrës obliguese. Përbërja e Bordeve të Drejtorëve paraqet një fakt mjaft interesant për shkak se minoritetet kanë arritur një përqindje edhe pse të kufizuar nëpër këto Borde. Do të jetë mjaft inkurajuese nëse shohim një përfaqësim të duhur të minoriteteve nëpër Bordet e Drejtorëve, fakt ky për të cilin pritet të arrihet marrëveshja në të ardhmen.
76. Siç theksuam në vlerësimin e fundit në lidhje me rolin e vazhduar të strukturës së UNMIK-ut, veçanërisht të Administratorëve Komunal dhe PSSP-së, mbetet një gjë mjaft kryesore, sidomos në aspektin e monitorimit se si strukturat e reja i mbrojnë të drejtat e minoriteteve, dhe çka është më e rëndësishmja në këtë drejtim, është se Administratorët Komunal dhe PSSP-ja mbajnë pushtetin e tyre të gjerë për të intervenuar në këtë aspekt në bazë të Rregullores 2000/45. PSSP-ja ka pushtet (fuqi) që të anulojë çdo vendim të marrur nga ana e komunës e cila “nuk i merr në konsideratë mjaft të drejtat dhe interesat e komuniteteve të cilët nuk paraqesin popullatën shumicë në komunat ku jetojnë”

(seksioni 47.2). Administratori Komunal “do të ndërtojë në mënyrë që të sigurojë që të parimet themelore të të drejtave të njeriut dhe trajtimit të barabartë të respektohen dhe që të drejtat dhe interesat e komuniteteve përkatëse të mbrohen” (seksioni 48.2). Dhe PSSP-ja, Administratori Komunal i KB-ve dhe vetë komuna kanë për detyrë që të krijojnë kushtet lokale për kthimin e personave të zhvendosur dhe refugjatëve (seksioni 48.4). Është shumë e rëndësishme që pushtetet në fjalë të shfrytëzohen në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.

## Punësimi

77. Në vlerësimet e fundit për minoritetet, ne bëmë me dije se **mundësia për punësim** për pjesëtarët e komuniteteve minoritare është tejet kryciale për sa i përket sigurimit të qëndrueshmërisë afatgjate të këtyre komuniteteve, dhe të të kthyerve. Një burim tjetër i mundshëm për një punësim të tillë është shërbimi civil komunal i cili punon në kuadër të secilës komunë. Përderisa të mos përpilohen dhe zbatohen në praktikë masat specifike të cilat do të sigurojnë një përfaqësim të minoriteteve nëpër Asembletë Komunale, kurfarë sistemi i tillë detyruar nuk është implementuar ende sa i përket përfaqësimit të minoriteteve nëpër shërbimet përkatëse civile komunale. (Meqë, siç do të potencojmë mëposhtë, komunat kanë obligim ligjor që të sigurojnë një përfaqësim të drejtë të të gjithëve si dhe Komitetet e Komuniteteve dhe Komiteti për Ndërmjetësim për të cilët folëm më lartë luajnë një rol të rëndësishëm në përparimin që është duke u bërë në fushën e monitorimit të tyre). Mu për këtë arsye ne jemi fokusuar në në këtë sferë, duke shikuar në veçanti për shembuj të praktikës së mirë të sigurimit të barabartësisë për sa i përket mundësive për punësim, dëshmitë për zbatimin e një politike të qartë dhe jodiskriminuese, dhe gjithashtu duke shikuar në masat speciale të përkohshme të cilat do të mund jenë marrë me qëllim të sigurimit të vendeve të punës për minoritete. Informatat e mbledhura gjer më tani bëjnë me dije për një pasqyrë e cila ndryshon prej vendi në vend përgjatë tërë Kosovës. Në këtë drejtim secila komunë duhet të miratojë politika të ndryshme për punësim, ku disa prej tyre nuk posedojnë me kurrfarë politike apo madje kanë edhe politika të ndryshme në kuadër të departamenteve të tyre.<sup>14</sup>
78. Nevoja për të poseduar me një **politikë të zakonshme të punësimit** me qëllim të parandalimit të diskriminimit paraqet një rëndësi prej nevojave e cila është identifikuar me Vlerësimin e fundit mbi minoritetet. Rregullorja 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë bën të njohur parimet në lidhje me Shërbimin Civil Komunal, duke kërkuar që kushtet e shërbimit duhet të lejojnë rekrutimin e stafit në bazë të kriterit meritore dhe kompetencave.<sup>15</sup> Rregullorja gjithashtu kërkon që shërbimi civil të reflektojë një “proporcionalitet të drejtë” të përfaqësuesve të kualifikuar të të gjitha komuniteteve në të gjitha nivelet.
73. Rregullorja 2000/45, **nuk parasheh udhëzim specifik se si do të realizohen këto standarde**. Sidoqoftë, një udhëzim të detajuar vetëm se ekziston në formë të “Mundësive për punësim” e cila është pregaditur në nëntor të vitit 2000, pas zgjedhjeve komunale. “Mundësitë” janë të destinuara si udhëzime mbi mundësitë e barabarta në konkurs, intervistë dhe zgjedhjen e kandidatëve për vendet e punës në komunë dhe përmbajnë udhëzime të detajuara dhe praktike siç janë përkufizimi i mënyrës së procedurës së intervistimit. Implementimi i drejtë i udhëzimeve të tilla, garanton për secilin të ketë mundësi të shijoj konkurset për vende të lira pune, të aplikojnë për ato vende dhe të intervistohen e të zgjedhen në mënyrë meritore për ato vende. Sigurimi i mundësive të barabarta mund të kërkoj edhe masa plotësuese speciale për disa grupe të caktuara, siç janë shfrytëzimi i mediave të minoriteteve për tu siguruar se konkurset për punësim janë të arritshme për komunitetet e minoriteteve, dhe organizimin e përcjelljes për të siguruar se të gjithë kandidatët në listën e ngushtë për intervistim të marrin pjesë në ato intervista.

<sup>14</sup> Në këtë fazë, nuk është e mundur që të fitojmë një pasqyrë uniforme për sa i përket punësimit në kuadër të secilës komunë për shkak se secila prej tyre gjendet në fazë të ndryshme të zhvillimit. Disa prej tyre funksionojnë plotësisht, përderisa të tjerat, për arsye siç janë vonesat në finalizimin e anëtarësisë së Bordeve komunale, gjenden në fazat e hershme të zhvillimit të tyre.

<sup>15</sup> Seksioni 34.2

Pas kësaj, mund të shfaqet nevoja për vendosjen e përcjelljeve të sigurisë apo organizimit të udhëtimeve speciale për tu siguruar se kandidatët e zgjedhur të shkojnë në vendin e tyre të punës. Gjithashtu është i nevojshëm monitorimi i vuarjes në jetë dhe efektivitetit të politikës për tu siguruar se e njëjta është zbatuar drejtë dhe në mënyrë konsistente. Rekrutimi dhe mbajtja e të punësuarve të përkatësive minoritare bartë në vete edhe implikime plotësuese të mjeteve materiale. Sidoqoftë, pasiqë komunitetet e minoriteteve nuk mund të vetëmbahen për një kohë të gjatë pa punësim, ndarja e këtyre mjeteve materiale plotësuese paraqitet si fundamentale.

74. Informatat nga terreni indikojnë në faktin se **“Mundësitë për punësim”** nuk janë pranuar nga të gjitha komunat dhe se rrallë është përdorur në mënyrë të drejtpërdrejtë, edhe pse politika të përafërta më përmbajtje të këtyre udhëzimeve ekzistojnë në disa komuna. P.sh. në Dragash, raportohet se “Mundësitë” janë implementuar në tërësi dhe mëtohet të mbahet një baraspeshë e drejtë etnike në shërbimet publike të komunës. Në Klinë, fillimisht komuna nuk u pajtua për politikën e unisuar të punësimit. Zyrtarët në Klinë kanë bërë me dije se atyre nuk ju është dërguar “Mudësitë” në gjuhën Shqipe deri pas xhiros së parë të rekrutimit në fillim të tetorit 2000, por tani komuna ka miratuar “Mundësitë” dhe është duke shfrytëzuar të njëjtën për intervistime dhe tash së voni ka krijuar Komisionin për kuadro. Në Istogun fqinjë, të intervistuarit kanë theksuar se ata asnjëherë nuk kanë pasur rastin të marrin udhëzimet mbi punësimin. Përderisa në Prizren nuk ekziston ndonjë politike e unisuar, e secili Departament miraton masat e veta, kjo praktikë qëndron larg prej asaj ideale pasiqë nënkupton se kandidatët për Departamente të ndryshme do të trajtohen në mënyra të ndryshme, pa ndonjë justifikim legjitim për atë trajtim të ndryshëm. Në Lipjan, komuna ka bërë publike qëllimin e saj për politikën e unisuar të punësimit por akoma nuk është finalizuar.
75. Ekziston edhe një ndryshim i konsiderueshëm në atë se si komunat **mbajnë të dhënat** e të punësuarve të tyre. P.sh. nuk ishte e mundur të merrej një statistikë e punësimit mbi baza të përkatësisë etnike, thjeshtë pasiqë të gjitha komunat nuk i mbajnë statistikën e tilla. Përderisa ekziston një pasqyrë e qartë mbi anëtarët e zgjedhur dhe të emëruar të Asamblesë Komunale, një pasqyrë e tillë momentalisht nuk ekziston sa i përket shërbimit publik. Monitorimi i punësimit mund të ndihmojë në identifikimin e një numri të rëndësishëm indikatorësh, jo vetëm për proporcionalitetin relativ të komuniteteve të ndryshme të punësuar, por edhe për llojet e punëve të cilët i kryejnë ata. Të dhënat e tilla mund të zbulojnë p.sh. shkallën e lartë të punësimit për minoritetin e caktuar por, për punë të cilat paguhen shumë pak, apo nëse Departamente të caktuara më shumë se të tjerat punësojnë minoritete. Në rrethanat e marrjes parasysh të këtyre numrave në konstatimin nëse punësimi i minoriteteve është proporcional me përbërjen etnike të komunës, një punë e tillë nuk do të jetë e mundur derisa numri i saktë i popullsisë mos të jetë i gatshëm.<sup>16</sup> Sidoqoftë do të ishte e dobishme që komunat sa më parë që është e mundur të fillojnë me mbledhjen e të dhënave të tilla kështu që bilanci i tanishëm edhe ai i ardhshëm të mund të vlerësohej.<sup>17</sup>
76. Sidoqoftë, disa numra ishin të gatshëm në shumicën e komunave. Ata indikojnë se **shumica e komunave punësojnë punëtorë të përkatësive të ndryshme etnike**. Në Pejë, p.sh. 2.6% të punëtorëve në komunë janë Boshnjak; 0.9% janë Serb të Kosovës; 0.3 janë Egjiptas; dhe 0.001% janë Rom; nuk kishte ndonjë analizë statistikore të gatshme mbi shkallën e punësimit. Në Prizren, 11% të personelit komunal janë Slavo-Musliman; 9% Turq; 1.3% Serb të Kosovës dhe 0.7% janë Rom. Numrat e gatshëm për Rahovec indikojnë se 24.5% të listës së rrogave të personelit komunal janë Serb të

<sup>16</sup> Kjo nuk do të thotë se ndonjë direktivë për territorin e Kosovës mbi punësimin proporcional të minoriteteve duhet të përputhet domosdoshmërisht me përbërjen e saktë të minoriteteve; kjo mund të përcaktohet në dritën e mundësive të kufizuara për minoritetet në sektorin privat dhe lirisë së kufizuar të lëvizjes, kështu që secili numër i paraqitur mund të tejkaloj proporcionalitetin e popullatës.

<sup>17</sup> Një punë e tillë më së miri do të realizohej si pjesë e monitorimit të punësimin në tërësi, punë e cila do të bënte ndarjen statistikore në bazë të gjinise sikurse asaj të përkatësisë etnike.



Kosovës<sup>18</sup>. Në Gjilan, 14% të personelit vijnë nga minoritetet, edhe pse asnjë Rom momentalisht nuk është punësuar në komunë. Nga Vushtrria raportohet se 3.2% e personelit komunal janë Serb të Kosovës. Në përgjithësi, derisa shumica e komunave me popullatë të minoriteteve punësojnë njerëzit nga këto minoritete, duket se Romët posaqërisht nuk janë të përfaqësuar. Romët kanë ngritur zërin e tyre në mënyrë të vazhdueshme lidhur me shqetësimet e tyre mbi mungesën e qasjes së tyre në të gjitha fushat e punësimit, përfshirë këtu edhe organizatat ndërkombëtare; përmbushja e kritereve mundet me qenë qështje e vështirë për Romët të cilët në të shumtën e rasteve nuk kanë edukim formal të mjaftueshëm por ky arsyetim nuk mund të bëhet për pjestarët e këtij komuniteti në tërësi. Edhe atëherë kur ata punësohen nga komuna ato janë vende të thjeshta të punës. Në Klinë p.sh. dy Rome janë të punësuar në ekipin e pastruesve. Në Leposaviq ku Serbët përbëjnë shumicën, organi komunal ka raportuar se ka punësuar tre Slavo-Musliman por edhe që nuk ka punësuar asnjë Shqiptar të Kosovës në periudhën pas luftës.

77. Komunitat kanë marrë qëndrime të ndryshme mbi atë se për cilat vende të punës duhet të shpallin konkursin, a do të shpallin apo jo konkursin e reja për vendet ekzistuese të punës, apo thjeshtë do të mbajnë personelin e tanishëm. Komunitat kanë marrur qëndrime të ndryshme për sa i përket faktit se për çfarë pozita të punës të shpallin konkursin përkatës, se a do të rishpallen konkursin përkitazi me pozitën ekzistuese të punës, dhe se a do të mbajnë në punë stafin e tanishëm. Në Kamenice/Kosovska Kamenica, kur kontratat e tanishme punës pritet të përfundojnë, për të gjitha pozitën e punës në kuadër të komunës do të shpallen konkursin përkatës duke u bazuar në politikën e cila duhet të finalizohet në të ardhmen e cila në masë të madhe do t'ju përmbahet "udhëzimeve për punësim". Në të kundërtën p.sh, në Gjakovë/Djakovica, kurdo që Asembleja Komunale të pajtohet për të reduktuar numrin e përgjithshëm të stafit të komunës, dhe pasi që të bëhen këto reduktime, pozitën e mbetura të punës do të transferohen nëpër Departamentet e ndryshme. Në Kline/Klina, për shumicën e posteve në komunë ishin rishpallur konkursin dhe atë para zgjedhjeve komunale të 28 Tetorit, pra është bërë rekrutimi i ri i bazuar duke e shfrytëzuar kriterin meritore. Stafin i pakualifikuar, edhe pse i emëruar mëparë, nuk ishte riemëruar nëpër pozitën përkatëse të punës. Një pjesë e shumëllojshmërisë së praktikave të zbatuara në këtë drejtim sigurisht se rezultojnë prej mungesës së qartësisë në Rregulloren 2000/45, Seksioni 52, i cili thotë se "zgjedhjet nuk përbëjnë ndonjë shkak për të rimarrur parrasysht këto emërimet [shërbimi civil komunal]" mirëpo nuk pengon në mënyrë eksplicite marrjen në rikonsideratë të tyre.
78. Nëse minoritetet dëshirojnë që të përfitojnë nga këto mundësi, hapi i parë i cili duhet ndërmarrur në këtë drejtim është që të sigurohet që ata të kenë **dijeni për këto mundësi**. Dy çështje me rëndësi kritike në këtë drejtim mund të jenë; e para; që të gjitha konkursin të shpallen edhe në gjuhën e minoriteteve dhe e dyta që ato konkurset të shpërndahen edhe nëpër komunitetet minoritare. Rregullorja 2000/45 kërkon që të gjitha dokumentet zyrtare nëpër komuna të shtypen në gjuhën shqipe dhe në atë serbe; përderisa në komunitat nëpër të cilat jetojnë komunitetet të cilat si gjuhë amtare nuk e kanë as gjuhën shqipe e as atë serbe, kështu që të gjitha dokumentet zyrtare duhet të jenë në dispozicion gjithashtu edhe në gjuhën e komunitetit. Liria e kufizuar e lëvizjes për minoritetet nënkupton se hapa shtesë duhet marrur në këtë drejtim me qëllim që të sigurohet që informatat përkitazi me mundësitë për punësim të arrijnë edhe nëpër zonat e populluara me minoritete. Përsëri praktika e përdorur në këtë aspekt është e shumëllojshme. Në Kline/Klina, na del se të gjitha konkursin e shpallura janë të shtypura vetëm në gjuhën angleze dhe atë shqipe. Gjithashtu ishte raportuar për faktin se për këto pozita të punës konkursin shpallen vetëm në tabelën e konkurseve në ndërtesën komunale apo në ndonjë ndërtesë tjetër publike. Një praktikë e tillë, në veti nuk është e mjaftueshme për të siguruar një distribuim të gjerë të konkurseve të shpallura. Për një praktikë të ngjashme ishte raportuar edhe në Prizren, ku të gjitha konkursin përsëri janë

<sup>18</sup> Kjo është një përqindje e lartë dhe e befalueshme për një komunë në të cilën numri i Serbëve në mënyrë dramatike është zvogëluar dhe ata të cilët kanë mbetur mendojnë të mbyllën në enklava me një liri shumë të kufizuar të lëvizjes. Prania e tyre në listën e rrogave nuk do të thotë se ata janë duke punuar në strukturën e tanishme komunale. Çështjet e sigurisë mund të përjashtojnë këtë mundësi por duket se këta punëtorë janë duke u paguar.

të përpiluara vetëm në gjuhën angleze dhe atë shqipe, gjatë së cilës zyrtarët e komunës theksuan se sipas të gjitha gjasave konkurset e përpiluara edhe në gjuhët e tjera janë hequr prej atyhit, andaj kjo na tregon se duhet përdorur metoda të tjera alternative të distribuimit të tyre nëpër lokalitetet ku jetojnë minoritetet.

79. Kudo tjetër, komunat kanë përdorur edhe metoda të tjera për shpalljen e konkurseve në lidhje me pozitat e ndryshme të punës. Në Rahovec/Orahovac, për shembull, Administratori Komunal është duke mbledhur në mënyrë aktive informata në lidhje me të gjithë personat të cilët janë të aftë për punë si dhe aftësitë e tyre të punës si në Rahovec ashtu edhe në Velika Hoca/Hoce e Madhe në mënyrë që të sigurohet që aplikantët e përshtatshëm të kenë njohuri në lidhje me mundësitë e përshtatshme për punësim. Shfrytëzimi i mediave është gjithashtu evident nëpër disa lokalitete; Gjilani/Gnjilane, për shembull, shfrytëzon një brez të gjerë të mediave vendore duke përfshirë këtu edhe një radio stacion lokal serb siç është Radio Maksi, në mënyrë që të sigurohet që pjesëtarët e minoriteteve të ndëgjojnë për pozitat përkatëse të punës. Sidoqoftë, shfrytëzimi i mediave nuk duket të jetë edhe aq i shpërndarë. Metodat e tjera mund të jenë edhe efikase e edhe të lira; shumica e Administratorëve Komunal mbajnë mbledhjet e tyre të rregullta me komunitetet minoritare apo me liderët e tyre në mënyrë që ti pajisin ata me këto informata gjatë këtyre mbledhjeve. Oficerët për Komunitetet Vendore gjithashtu mundën të ndihmojnë gjatë shpërndarjes së këtyre informatave, dhe mbledhjes së aplikacioneve; edhe pse ende nuk është zgjedhur problemi i dorëzimit të aplikacioneve nga ana e tyre në mënyrë të drejtëpërdrejtë; ku disa prej komunave bënë me dije se edhe ata kishin përdorur këtë kanal. Me të vërtetë, çdo organizatë e zellshme e cila i viziton rregullisht lokalitetet e banuara me minoritete mundën të lutën për të shpërndarë informata në lidhje me këto vende të punës; komuna e Lipjanit ka angazhuar KFOR-in në këtë aspekt.
80. Shembujt e praktikës së shkëlqyeshme të rekrutimit, disa prej të cilave janë përmendur edhe më lartë, janë gjithashtu evidente edhe nëpër disa lokalitete, sidomos në komunat juglindore. Në komunën e Gjilanit 44 prej 220 vendeve të punës janë ndarë (rezervuar) për minoritetet në bazë të Planit të Personelit të Asemblesë Komunale për Rekrutim. Komuna raporton se politika e saj e punësimit bazohet në Udhëzuesin për Punësim dhe gjithashtu bënë me dije se janë ndërmarrë hapa specifik në këtë drejtim; duke përfshirë këtu edhe përdorimin e mediave të minoriteteve, për ti reklamuar vendet e punës për minoritetet. Gjithsejt, komuna në fjalë ka punësuar 24 serbë dhe dy turq, edhe pse si duket nuk ka asnjë të punësuar të nacionalitetit rom. Kamenica fqinje do të miratojë së shpejti një politikë të unifikuar të punësimit e cila përfshin edhe masat speciale të cilat sigurojnë që komunitetet minoritare të kenë njohuri për sa i përket këtyre mundësive për punësim, duke përfshirë këtu edhe masat specifike për publikimin e konkurseve edhe për komunitetin rom. OSBE-ja ka monitoruar gjer më tani disa prej intervistave për punë të mbajtura nga ana e Komunës, gjatë së cilës ata përfunduan se këto intervista ishin korrekte dhe të gjitha vendimet në këtë drejtim ishin marrur sipas kriterit merititor.
81. Nëse kërkesat e dala nga Rregullorja 2000/45 duhet plotësuar, është mjaft thelbësore që të gjitha komunat të miratojnë një **politikë të drejtë dhe uniforme për punësim** e cila siguron mundësi për punësim për të gjithë pjesëtarët e komuniteteve minoritare dhe përfundimisht ajo siguron një selektim merititor të kandidatëve. Me qëllim që të arrihet një gjë e tillë, shumica e mangësive të tanishme të punësimit të prezentuara më lartë duhet patjetër të studiohen dhe të zgjidhen. Reklamimi special dhe shpërndarja e tyre me qëllim që minoritetet të kenë njohuri mbi mundësitë për punësim, duke përfshirë këtu edhe përdorimin e gjuhës, dhe përdorimin e praktikave të mundësive të barabarta për intervistë, si dhe këtu duhet të hyjë edhe mbledhja e rregullt e statistikave relevante në këtë drejtim; të gjitha këto së bashku duhet të paraqesin një praktikë të zakonshme. Për shkak se jemi duke u munduar që të korrigjojmë mungesën e baraspeshës etnike dhe pasi që njerëzit e ndryshëm të jenë punësuar kjo mund të rezultojë që punëtorët e tanishëm të pushohen nga puna apo që kontratat e tyre të mos zgjaten, të gjitha ato komuna të cilat do të duhet të zbatojnë procedurat përkatëse të selektimit të kandidatëve do të bëjnë shumë mirë nëse do ti hartojnë politikat e tyre të punësimit para se t'ja nisnin me rekrutimin e personave. Për ato komuna të cilat kanë marrur në punë stafin e tyre, procesi i korrigjimit të mungesës së baraspeshës etnike në këtë drejtim mund të merr

mjaft kohë. Përtej këtyre masave të rekrutimit, nëse romët në veçanti nuk do të jenë ata të cilët do të humbin për shkak të mungesës së kualifikimeve të tyre në këtë drejtim; iniciativat e trajnimit të artizanateve të cilat u dedikohen në veçanti këtij grupi etnik do të jenë, edhe pse në planin afatgjatë, një mjet për sigurimin e mundësive të barabarta për punësim në shërbimin civil komunal. Duke e pasur parasysh se direktivat mbi rekrutimin gjithëpërfshirës ekzistojnë në këtë drejtim, disa prej tyre do të mundënin që të implementoheshin shumë shpejt dhe në mënyrë mjaft të qëndrueshme.

82. Përderisa politikat e qarta mbi mundësitë e barabarta për punësim janë mëse të nevojshme, këto mund të implementohen në mënyrë të drejtë vetëm nëse pjesëtarët e minoriteteve posedojnë me **mjete juridike efektive** që mund të shfrytëzohen kundër akteve të diskriminimit në punë. Edhe pse Ombudspersoni mund të luajë një rol mjaft të rëndësishëm në këtë drejtim, duke krijuar mjete juridike efektive e cila nënkupton se minoritetet do të mund të jenë në gjendje që rastet e tyre të punësimit të paraqesin në gjyq. Për momentin nuk ekziston ndonjë ligj gjithëpërfshirës mbi punën i cili do të përmbante dispozita të cilat parandalojnë diskriminimin në këtë aspekt. Një Rregullore e re është duke u pregaditur me qëllim që të shërbejë si përgjegje e vakumit juridik i cili mbretëron në fushën e ligjit të punës. Në ndërkohë mungesa e kornizës juridike në këtë drejtim në masë të madhe pengon qajsen e barabartë ndaj gjyqeve për të gjithë ata të cilët pohojnë për diskriminime në këtë aspekt. As OSBE-ja e as UNHCR-ja nuk i kanë të njohura rastet ta cilat kanë përfunduar në gjyq me përjashtim të një rasti në rajonin e Pejës. Vetëm në një komunë, në Prizren, janë bërë përpjekje të dukshme si nga popullata shumicë dhe nga ajo pakicë me qëllim të sigurimit të mjeteve juridike në rastet e punësimit. Në bazë të Këshillit Norvegjez për Refugjat (KNR) në Prizren, deri në Shkurt të vitit 2001 ata i kanë dalur në ndihmë deri 46 personave, duke përfshirë këtu edhe 14 pjesëtarë të minoriteteve, me qëllim që të ndjek penalisht të gjitha rastet për të cilat ekziston pohimi për pushim të padrejtë nga puna apo refuzimit gjatë aplikimit për ndonjë vend të punës. Edhe pse Departamenti Administrativ i Drejtyësisë ka lëshuar direktiva (udhëzime) për të gjitha gjyqet në mënyrë që të pranojnë rastet e tilla në gjyq, të cilat raste duhet ende që të ndëgjohen (shqyrtohen) dhe të gjykohen. Si duket në kuadër të gjyqeve këtu në Kosovë ende nuk ekziston ndonjë Dhomë e cila do të merret me çështjet e Ligjit të Punës. Gjyqi Komunal në Prizren për momentin ka theksuar se për momentin është duke kërkuar për një specialist "gjyqtar të punës", edhe pse ka bërë me dije se do të fillojë që ti ndëgjojë rastet e tilla në të ardhmen e afërt.

## Përfundimet dhe Rekomandimet

### **SIGURIA**

Siguria mbetet një çështje që brengos më së shumti për të gjitha komunitetet minoritare dhe gjithashtu një çështje e cila ndikon në ushtrimin e të drejtave të tyre në këtë drejtim. Përderisa përgjegjësia për sigurinë bie mbi KFOR-in dhe Policinë e UNMIK-ut, kjo gjithashtu paraqet një çështje e cila kërkon një kontribut të dhënë edhe nga një grup më i gjerë akterësh në këtë drejtim. Andaj rekomandohet që Zëvendësi i Parë i PSSP-së të thërras mbledhjen e jashtëzakonshme të planifikuar të **Grupit Punues në mes të Shtyllave të UNMIK-ut** mbi Sigurinë.

### **KTHIMI**

Çështja e kthimit në thelb është e ndërlidhur me atë të sigurisë. Kërcënimet ndaj sigurisë së grupeve minoritare vazhdojnë të përjashtojnë mundësinë e promovimit të idesë së kthimit të këtyre personave në këtë fazë. Serbët e Kosovës dhe RAE janë në rrezik të veçantë dhe nën kurrfarë rrethanash ata nuk guxojnë të deportohen nga ana e shteteve azilpranuese. Indikacionet e kohëve të fundit bëjnë me dije për faktin se grupet minoritare janë duke u ballafaquar me një intenzitet më të vogël të kërcënimeve ndaj sigurisë së tyre, mirëpo prapsepapë situata e sigurisë mbetet e paqëndrueshme (brishtë) në këtë drejtim.

### **KUJDESI SHËNDETËSOR**

Emërimi i **Oficerëve për Minoritete** në kuadër të Departamentit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është një gjest mëse i mirëseardhur. Departamentet e tjera duhet të konsiderojnë që edhe ata të bëjnë emërimet të tilla, dhe që të sigurojnë që Oficeri për Minoritete të jetë i kyçur që nga fillimi në politikë dhe vendim marrje ashtu që komunitetet minoritare të mund të integrohen plotësisht në procesin e planifikimit dhe implementimit.

Një shqyrtim (analizë) i plotë, së bashku me Departamentet relevante Komunale, si dhe OJQ-të vendore dhe ato ndërkombëtare, për sa i përket sigurimit të kujdesit shëndetësor primar për komunitetet minoritare duhet të kryhet në kuadër të ombrellës së Departamentit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Ky shqyrtim (analizë) duhet të ketë për qëllim që të identifikojë zbrastësirat e tanishme dhe ato që mund të paraqiten në të ardhmen, gjithashtu duhet të shikojë në faktin se si qëllimi i përgjithshëm për sa i përket një shërbimi plotësisht të integruar të kujdesit shëndetësor mund të arrihet. Rezultatet e anketës së mbajtur nga ana e OBSH-së duhet të dëshmojë se paraqet një kontribut mjaft të çmueshëm në këtë drejtim.

### **PRONA**

Brenda në Kosovë, është shumë e rëndësishme që të hapen urgjentisht zyret regjionale të HPD-së në të gjitha regjionet ashtu që shfrytëzimi i ekipeve mobile në këtë aspekt do të vazhdoi që të bëhet me qëllim që të sigurojë qasje të barabartë për minoritetet ndaj kësaj zyreje. Një përkrahje e plotë duhet dhënë HPD-së me qëllim që të sigurohet një përfundim i shpejtë dhe i drejtë i procesit të hapjes së zyrës në Beograd. Një proces i ngjashëm nevojitet me qëllim që të përfundohen punët edhe rreth hapjes së zyrës në Mal të Zi.

Përderisa mungesa e fondeve vazhdon të pengojë HPD-në në hapjen e të gjitha zyreve të cilat i ka planifikuar ti hap, dhe përderisa qasja ndaj mekanizmit për ankesa HPCC mbetet një gjë e padrejtë, afati i tanishëm kohor për dorëzimin e aplikacioneve HPD-së (i cili është 31 Dhjetori 2001) duhet të rishqyrtohet.

## **PUNËSIMI**

Për ato komuna të cilat nuk e kanë bërë një gjë të tillë, një politikë e unifikuar për punësim duhet miratuar; **Programi ekzistues për Punësim** mund të shfrytëzohet si një model mjaft efektiv. Pasi që të jetë implementuar, përparimi i arritur drejt realizimit të qëllimeve duhet të monitorohet, dhe sipas nevojës, kur të jenë bërë përshtatjet e duhura në shpalljen e konkursit, praktikat e intervistimit dhe selektimit të kandidatëve, ato gjithashtu duhet të marrin parrasysh edhe nevojat e aplikantëve minoritar.

Të gjitha komunat, ndoshta nëpërmjet të Komiteteve të tyre të Komuniteteve, duhet të mbledhin statistikën e punësimit, ku njëkohësisht edhe duhet të gjejnë shumën e përgjithshme të tyre. Pasi që të jetë bërë një gjë e tillë, statistikën në fjalë duhet të nënshtrohen rishqyrtimeve dhe atë në baza të rregullta. Statistikën e tilla jo vetëm që duhet të përfshijnë përkatësinë etnike, mirëpo gjithashtu edhe llojin e punëve të cilat grupet përkatëse minoritare i punojnë si dhe grupet e tjera siç janë gratë.

Duke pasur parrasysh faktin se mjetet juridike efektive të cilat shërbejnë për ti ndëgjuar dhe shqyrtuar pohimet për sa i përket pushimeve të padrejta nga puna mbeten të mangëta në shumë fusha, mund të jetë e nevojshme që të përcaktojmë një politikë e cila merret me raste të tilla që mundësojnë një qasje të drejtë ndaj këtij problemi në të gjitha komunat.

## **STRUKTURAT POLITIKE**

Përderisa të kuptojmë vështirësitë me të cilat ballafaqohen disa prej komunave gjatë arritjes së marrëveshjes për sa i përket përbërjes së organeve të zgjedhura dhe atyre të emëruara komunale, është esenciale që procesi në fjalë të finalizohet sa më shpejtë që është e mundur.

Trajnimi për organet komunale duhet të pasojë menjëherë pas emërimit të tyre me qëllim që të sigurohet që ata të arrijnë funksionalitet të plotë sa më shpejtë që është e mundur.